

1 E martë, 18 korrik 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Sekretare,  
6 mund të paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. KSC-BC-  
8 2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri  
9 Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
11 Mirëmëngjesi, të tjerëve. Sot do të përfundojmë dëshminë  
12 e Dëshmitarit 04576. Do fillojmë me dëshminë 02153.

13 Vërej për procesverbal që z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi,  
14 z. Krasniqi janë të gjithë të pranishëm në të sallën e gjyqit.

15 Sekretare, mund të sillni dëshmitarin.

16 [Dëshmitari vijon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
18 mund të uleni.

19 Dëshmitar, po të kemi fat, do të përfundojmë sot me  
20 dëshminë tuaj. Besoj se do ju bëhet qejfi për këtë. Do të  
21 vazhdojmë me pyetjet e Gjykatësit Mettraux dhe pastaj do të  
22 lutem shohim çfarë pyetjesh kanë mbetur për seancën e  
23 paradites. Ju lutem kushtojeni vëmendjen e duhur.

24 Gjykatësi Mettraux, keni fjalën.

25 DËSHMITARI: W04576 [Vijon]

1 Pyetje nga Trupi Gjykses: [Vazhdon]

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëmëngjes, z. Mustafa.  
3 PË. Mirëmëngjes.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam tre fusha që dua të  
5 trajtoj me ju. E para.

6 Dje s'isha shumë i qartë sa i takon disa përgjigjeve që  
7 dhatë lidhur me zinxhirin e komandës, prandaj kam nevojë të  
8 sqaroj disa prej gjërave. E para: E pranoni që gjatë periudhës  
9 përkatëse 1998 deri në verën e 1999, ju ishit në varësi të  
10 Shtabit të Përgjithshëm, e pranoni këtë - ju si zonë - ishit ë  
11 varësi të Shtabit të Përgjithshëm?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Duke përdorur, mbase,  
14 fjalët tuaja po, a e pranoni propozimin se, në fakt, zona  
15 operative ishte niveli i dytë në zinxhirin e komandës, në  
16 vartësi të nivelit të parë që në fakt ishte Shtabi i  
17 Përgjithshëm, e pranoni këtë?

18 PË. Është niveli i parë operativ. Kurse mbi vete kishte  
19 Shtabin e Përgjithshëm, i cili po konsolidohej.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani do t'ju pyes me diçka  
21 tjetër. Ka lidhje me një dokument që jua treguan javën e  
22 kaluar më 12 korrik. Faqja 5586, nëse ju ndihmon. Dhe do t'i  
23 kërkoj Zyrës Administrative të na shfaqë këtë dokument në  
24 ekran. Është SITF00069163. Shqipja SITF00243091 deri në  
25 SITF00243150. Faqja për shqipen mund të jetë 43130.

1 Faleminderit.

2 Zotëri, ju kujtohet që ua treguan këtë dokument javën e  
3 kaluar?

4 PË. Po.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kjo është një listë me  
6 personat që janë mbajtur në ndalim në zonën tuaj gjatë  
7 periudhës përkatëse. Nëse i hedhim një sy, qoftë anglishten  
8 apo shqipen, shohim disa kolona ku ka informacion për këta  
9 individë - kush i solli, kur janë ndaluar për herë të parë,  
10 kur janë liruar e kështu me radhë. I shihni këto informacione,  
11 këto të dhëna?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tanimë në veçanti dua t'ju  
14 pyes për një faqe në këtë dokument. Në anglisht është  
15 SITF00069167. Ndërsa shqipja është e njëjta gjë po mbaron në  
16 fund me 3138.

17 Fillimisht do ju kërkoj të shohim numrin 40, personin tek  
18 numri 40. Nëse shkojmë pak më djathtas tek shqipja, në qoftë  
19 se është e mundur. Nuk është shumë e qartë në ekran,  
20 megjithatë po ju them çfarë thotë anglishtja.

21 Thotë që personi te numri 40, tek rreshti 40, u soll:

22 "Si pjesë e UÇK-së - Gollapit".

23 A mund të na shpjegoni çfarë do të thotë kjo?

24 PË. Këtu po bëhet fjalë se cilat njësi e kanë pru. Është  
25 Brigada 153. Domethënë, personi ka ardhë nga Brigada 153, nga

1 fshatrat e Gollakut, fshatrat e Prishtinës.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Nga 41  
3 pastaj te 45, personat në këto rreshta janë ndaluar me urdhër  
4 të sektorit informativ apo të shërbimit informativ të  
5 inteligjencës të zonës suaj, është e saktë?

6 PË. Këtu po shkruan se po.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim djathtas, rreshti  
8 numri 41. Dhe anglishten dhe shqipen.

9 Thotë që ky personi "ka ardhur me ftesë". E ka fjalën  
10 praktikisht se këtij personi i dhënë një urdhër apo i dhanë  
11 një kërkesë edhe personi u paraqit në bazë të kësaj kërkesë që  
12 i dhanë? E kam kuptuar siç duhet?

13 PË. Po ka mund me kanë ftesë e thjeshtë, z. Gjyqtar, të  
14 lajmërohet në bazën e UÇK-së, në njësitet e UÇK-së ku gjinden  
15 ma së pari, ku mundmi t'i takojmë më herët.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të thotë që ekzistonin  
17 dy lloje dokumentesh, një thirrje dhe një ftesë, apo ftesë dhe  
18 thirrje, në fakt, janë e njëjta gjë?

19 PË. E njëjta gjë duhet të jenë. Po ka pasë ftesa gojore  
20 përmes personit të dytë, përmes ushtarëve tonë, ka pasë forma  
21 tjera. Unë tash nuk muj e di në cilën formë janë thirr, po ka  
22 qenë thirrje normale për këdo që kena mujt me i çu fjalë.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Katër personat e tjerë nga  
24 42, 43, 44 dhe 45, thotë që janë sjellë nga SHIK-u dhe policia  
25 ushtarake, e saktë?

1 PË. Po, z. Kryetar. Unë ju kam treguar dhe më herët anëtarët  
2 e komandës, të gjithë dhe niveli i brigadës kanë pasë të  
3 drejtë të urdhërojnë të sjellin njerëz.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani dua t'ju pyes për  
5 dokumentin e fundit. Do i lutesha Sekretares, provën materiale  
6 P104.

7 Po ju jap pak kohë që të njiheni me faqen e parë. Thjesht  
8 hidhini një sy për të kuptuar kontekstin. Dhe më thoni kur të  
9 keni mbaruar së lexuari.

10 PË. Unë u njoha me këtë dokument tash, e lexova.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim faqen tjetër. Faqen  
12 tjetër.

13 Këtu kemi një dokument të SHIK-ut të Kosovës, që është  
14 një listë që përmban persona të dyshuar si bashkëpunëtorë,  
15 kështu është përkthyer këtu bashkëpunëtor, që janë nga zona e  
16 përgjegjësisë suaj Podujevës.

17 Fillimisht, do ju pyes: A njihni ndonjë nga personat e  
18 renditur në këtë listë, çfarë dua të them, dua të them, a  
19 njihni ndonjë nga emrat në këtë listë?

20 PË. Jo, z. Kryetar, nuk i njoh.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Alush Kastrati, Osman  
22 Sinani, Hetem Jashari, s'të thonë asgjë?

23 PË. Jo, asgjë s'më thonë.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, asnjë prej këtyre nuk  
25 mendoni se është mbajtur nën autoritetin tuaj ose nuk e dini

1 që është mbajtur nën autoritetin tuaj?

2 PË. Jo, nuk e di që është mbajtur. Ka mujt me u mbajtur, kam  
3 mendu këto. Po tani s'më thotë gjë.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyes ndryshe: E njihni  
5 këtë dokument?

6 PË. Jo, z. Kryetar.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini kush ishte në  
8 pozitë të mblidhte këtë informacion brenda zonës suaj?

9 PË. Nuk besoj që është dokument i kohës së UÇK-së dhe i zonës  
10 time.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Çfarë ju shtyn ta thoni  
12 këtë?

13 PË. Ju po thoni që dokumenti është gjetur mbas lufte nga UNMIK-  
14 u në zyrat e SHIK-ut. S'kanë lidhje këto dokumente me kohën e  
15 luftës.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse ju kuptoj siç duhet  
17 është SHIK-u pas luftës pas faktit, pra, krijoi një listë të  
18 bashkëpunëtorëve në zonën tuaj, këste po thoni?

19 PË. Këtë nuk mund ta them unë. Nuk e di. Por ju po thoni që  
20 dokumentet janë gjetur nga policia e UNMIK-ut. Po unë vetëm po  
21 them që ky dokument nuk është i njohur për mua dhe s'ka lidhje  
22 me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirë, po jua them ndryshe.  
24 A e pranoni që personi brenda zonës suaj operative dhe pranë  
25 komandës suaj operative që mund ta kishte këtë informacion

1 është Latif Gashi, s'është kështu?

2 PË. Nuk kam njohuri për këtë kohë as çfarë informatash ka  
3 pasë, z. Kryetar -- z. Gjyqtar.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por ama e dini dhe unë  
5 mund t'jua lexoj deklaratën tuaj, por ama ju e dini që një nga  
6 detyrat e tij ishte të mblidhte informata për bashkëpunëtorët  
7 në zonën tuaj, e pranoni këtë?

8 PË. Po. Sa ishte nën komandën e zonës së UÇK-së.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ka pasur ndonjë person  
10 tjetër brenda zonës suaj që mund ta kishte këtë informacion  
11 për veç z. Gashi?

12 PË. Për këtë informacion që po flasim unë nuk e di. Por  
13 informacionet që ka pasë Policia e Kosovës, z. Gashi apo  
14 kushdo nga komanda i kemi pasë të gjithë në anëtarët e  
15 komandës, i kemi pa. Dhe ka ardhë një moment që në s'kemi mujt  
16 me i rujt dokumentat dhe kushdo, te kushdo ka mujt me u gjind  
17 diçka pjesë të mbetura, sepse gjatë kohës së luftës kanë humb.  
18 Dokumentet që janë kanë të kësaj natyre i kemi pa të gjithë  
19 anëtarët e komandës.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ju sapa më thatë pari  
21 një çasti që ju nuk e njihnit as dokumentin dhe asnjë nga  
22 personat në atë dokument si komandant i zonës, kështu?

23 PË. Unë nuk fola tani për këtë dokument, fola për dokumente  
24 të kësaj natyre.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ju po thoni që jeni

1 në dijeni të këtij dokumenti dhe ishit në dijeni të

2 ekzistencës së këtij dokumenti aso kohe?

3 PË. Z. Gjyqtar, jam në dijeni se ka pasë dokumente të kësaj

4 natyre, jo për këtë lloj dokument.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Krijojmë, hamendësojmë,

6 thoni që njihni dokumente të ngjashme, supozojmë se ky

7 dokument ju dërgua Shtabit të Përgjithshëm, kush do të ishte

8 personi përgjegjës për ta ndarë këtë informatë me Shtabin e

9 Përgjithshëm? Ju personalisht apo dikush tjetër?

10 PË. Nuk ka pasë asnjë dërgesë në Shtabin e Përgjithshëm të

11 këso lloj informatave.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ju them diçka që e ka

13 thënë Fatmir Humolli, shefi i moralit. Fillimisht: A është e

14 drejtë të themi që Fatmir Humolli ishte axha ose daja e Hyzri

15 Tallës? E dini këtë?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Hyzri Talla ishte vartës i

18 z. Gashi, kështu?

19 PË. Punonin bashkë me z. Thaçi -- me z. Gashi, po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ajo që tha z. Humolli

21 është kështu, personi që përcillte informatat për

22 bashkëpunëtorët tek Shtabi i Përgjithshëm ishte Latif Gashi.

23 Dini gjë lidhur me këtë apo ndodhnin këto pa dijeninë tuaj?

24 PË. Asnjëherë nuk e kam dit këtë punë.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk mund të pres më. Kjo pyetje a



1 dini për këtë apo ndodhte pa dijeninë tuaj, mbi çfarë bazash  
2 sugjeroni se po ndodhte faktikisht diçka e tillë?

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Doni t'ju lexoj deklaratën  
4 e z. Humolli?

5 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po nuk ka prova konkrete që kjo  
6 ka ndodhur.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po i bëra një sugjerim.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po unë e di ndryshe versionin.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Janë pyetje  
10 të Trupit Gjykues.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] E pranoj, por ka edhe Trupi  
12 Gjykues përgjegjës në të këtë kujdes me pyetjet e veta që të  
13 mos shkojë përtej kuadrit të lejuar.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po e bëj dhe njëherë  
15 pyetjen.

16 A keni ndonjë arsye për të vënë në dyshim dëshminë e z.  
17 Humolli? Unë mund t'ju citoj çfarë ka thënë z. Humolli. Ai  
18 thotë personi që ishte përgjegjës brenda zonës tuaj për të  
19 informuar Shtabin e Përgjithshëm lidhur me informatat që janë  
20 mbledhur ishte shefi i shërbimit tuaj të inteligjencës, z.  
21 Latif Gashi. Keni ndonjë arsye për ta kundërshtuar dëshminë e  
22 z. Humolli?

23 PË. Unë asnjëherë nuk kam autorizue dhe nuk e kam ditë që ka  
24 pasë z. Gashi raporte me dikënd nga Shtabi i Përgjithshëm të  
25 UÇK-së deri pas luftës?

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, nëse ndodhte diçka e  
2 tillë kjo duhet të ndodhte pa dijeninë tuaj. E kam kuptuar  
3 saktë?

4 PË. Unë nuk di se ka ndodhë, as kam pasë arsye të besoj që ka  
5 ndodhë.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi  
8 Gaynor.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi  
10 Smith.

11 Z. Mustafa, dua t'ju bëj një pyetje sqaruese lidhur me  
12 një pyetje që bëri Prokurorja.

13 "PY. Kush ishte përgjegjës për qendrën e ndalimin në  
14 Llapashticë?

15 Ju jeni përgjigjur:

16 "Nazif Mehmeti ka qenë shefi i policisë ushtarake atje."

17 "PY. Policia ushtarake ishte përgjegjëse për qendrat e  
18 ndalimit?"

19 "PË. Po".

20 Dhe tani pyetja ime është kjo: Policia ushtarake ishte  
21 përgjegjëse për të gjitha qendrat e ndalimit të UÇK-së në  
22 zonën tuaj?

23 PË. Po, z. Gjyqtar.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A e kam kuptuar drejt që ju  
25 caktuat Nazif Mehmetin rreth tetorit 1998 si komandanti në

1 detyrë i policisë ushtarake në zonën tuaj?

2 PË. Përafërsisht mund të jetë kjo kohë. Nuk jam i sigurtë për  
3 kohën.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pas më pas u vendosë Mehmet  
5 Latifi në vendin e tij? Pra, kush ishte pasardhësi i Nazif  
6 Mehmetit si komandant i policisë ushtarake, kush pasoi?

7 PË. Nuk ka -- Muhamet Latifi ka ardhë krejt në kohën e fundit  
8 të luftës.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A ishte ai komandanti i  
10 policisë ushtarake në zonën tuaj?

11 PË. Po. Por ai ka qenë krejt në fund të luftës.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ju kujtohet saktësisht kur  
13 ka ndodhur?

14 PË. Pak ditë para hymjes në Prishtinë, zotëri.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani do t'ju pyes diçka sa i  
16 takon komandantëve të policisë ushtarake në nivel brigade.

17 Më 11 korrik në faqen 107 të transkriptit të asaj dite.  
18 Këtë po e them për referencë për pjesëmarrësit. Atje pyetja  
19 ishte:

20 "A kishte polici ushtarake në zonën operative të Llapit?

21 "PË. Po.

22 "PY. Në çfarë niveli? E kemi fjalën në nivel komande në  
23 strukturë.

24 "PË. Në nivel zone, në nivel brigade.

25 "PY. Policia ushtarake në nivel brigade kujt i

1 raportonte?

2 "PË. Komandantit të brigadës. Ishin në varësi të  
3 subordinuar brenda policisë ushtarake të zonës.

4 "PY. Pra, ata ishin në varësi të policisë ushtarake të  
5 nivelit të zonës?

6 "PË. Nuk ishin në varësi, por ishin bashkë të  
7 subordinuar".

8 Pastaj vazhdoni dhe e konfirmoni këtë dhe thoni që Nazif  
9 Mehmeti ishte përgjegjës për policinë ushtarake.

10 Dua t'i shtjelloj pak më shumë këto përgjigjet tuaja. Kur  
11 keni thënë që policia ushtarake në brigadë ishin të  
12 subordinuara, çfarë keni dashtë të thoni saktësisht? E keni  
13 fjalën që ishin në varësi të komandës së komandantit, pra, e  
14 keni fjalën që ishin në varësi të komandantit të brigadës 152,  
15 151 apo 153? Këtë keni dashtë të thoni?

16 PË. Komandanti i brigadës, z. Gjyqtar, ka urdhëruar në  
17 policinë e brigadës. Kurse njësia e zonës operative e  
18 udhëhequr nga Nazif Mehmeti është dashtë të koordinojë  
19 rregullat mbi të cilat po punonin. Janë koordinuar mes veti  
20 për t'u duk policia njësoj në të gjithë zonën.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, në aktivitetin e  
22 përditshëm, kush e drejtonte policinë ushtarake brenda  
23 Brigadës 151, 152 e 153? A ishte komandant i secilës prej  
24 brigadave apo Nazif Mehmeti?

25 PË. Jo, komandanti i brigadës.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua të sqaroj identitetin e  
2 komandantëve të policisë ushtarake për secilën brigadë. Kush  
3 ishte komandant i policisë ushtarake në Brigadën 151?

4 PË. Nuk e di.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mos ka qenë Naip Gubetini?

6 PË. Po, meqë ma treguat tani po e di çka thotë.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po komandanti i policisë  
8 ushtarake të Brigadës 152?

9 PË. Nuk më kujtohet. Vetëm nëse ma përkujtoni, unë mundna me  
10 e ditë, z. Gjyqtar. Por, ka evidenca mbi këto punë, janë  
11 publike. Domethënë, nuk po tentoj të fsheh asgjë sepse këto  
12 janë evidenca publike.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ka qenë Ramadan Jashari?

14 PË. Tash nuk po më kujtohet, po e di që ka qenë në policinë e  
15 Kosovës, në policinë ushtarake. Me siguri ka qenë nëse e keni  
16 marrë nga evidencat.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po komandanti i policisë  
18 ushtarake në Brigadën 153 kush ishte, e dini?

19 PË. Jo, nuk e di.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Si mund ta përshkruani  
21 marrëdhënien mes policisë ushtarake, komandantëve të policisë  
22 dhe oficerëve të policisë ushtarake në nivel brigade dhe  
23 komandantëve të brigadave të cilëve u raportonin?

24 PË. Po njësia e policisë ushtarake brenda brigadës ka qenë  
25 sektor i shtabit të brigadës. Ka qenë njësi pranë brigadës që

1 ka kryer punët dhe detyra brenda terrenit ku ishte [e  
2 pakuptueshme] brigada.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A keni marrë raporte në  
4 cilësinë tuaj si shef i komandës së zonës, keni marrë  
5 ndonjëherë raporte ku të përmendet të ketë pasur  
6 mosmarrëveshje apo tensione mes tyre?

7 PË. Nuk më kujtohet që ka pasë tensione ndërmjet policive  
8 ushtarake. Nuk e kujtoj.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Komandantët e policisë  
10 ushtarake në nivel brigade a komunikonin me njeri-tjetrin?

11 PË. Kanë mund të bisedojnë, të komunikojnë. Unë nuk e di  
12 këtë.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nga dëshmia juaj e kuptoj që  
14 keni pasë takime goxha të shpeshta me komandën e zonës suaj.  
15 Sa herë mbaheshin këto mbledhje?

16 PË. Nuk e di sa herë, por jemi taku sa herë që mundemi.  
17 Shpesh herë jam taku edhe veç e veç me anëtarë të komandës.  
18 Kam vizituar brigadat. Unë gjithherë kam qenë pranë eprorëve  
19 të mi.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kur kishit mbledhje të  
21 komandës së zonës, komandantët e Brigadave 151, 152, 153  
22 zakonisht ishin prezent në këto mbledhje?

23 PË. Komandantët e brigadave 152 dhe 151 kanë qenë më shpesh.  
24 I brigadës 153 jo, sepse ishte në pjesën tjetër, në krahun  
25 tjetër ku ishte më i vështirë komunikimi.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe do të flasë edhe për  
2 komunikimet por pak më vonë.

3 Me sa kuptoj nga dëshmia pak më herët që dhatë, Latif  
4 Gashi ka qenë anëtar i komandës së zonës. A e kam kuptuar  
5 drejtë që zakonisht që ai ishte prezent në mbledhjet që mbanit  
6 ju me komandën e zonës suaj?

7 PË. Po ka mund me qenë prezent ose z. Latif Gashi nuk ka mund  
8 të jetë shpeshherë në mbledhje sepse ka qenë i angazhuar me  
9 luftë. Ai angazhonte veten në vijën frontale dhe në detyra  
10 tjera që dilnin, që koha i din.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ju thatë në fakt, Nazif  
12 Mehmeti nuk ka qenë anëtar i komandës së zonës, por pyetja ime  
13 është kush e përfaqësonte policinë ushtarake në mbledhjet e  
14 komandës së zonës suaj?

15 PË. Kur kishte nevojë ai vinte në shtab dhe raportonte pranë  
16 shefit të shtabit. Ka pasë takime që i kemi ftuar dhe vetë z.  
17 Mehmeti të raportojë në mbledhje.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, supozoj duke qenë se  
19 komandantët e brigadave, në fakt, ishin eprorët e policisë  
20 ushtarake për secilën brigadë, vetë komandantët e brigadave  
21 kishin informacion të mjaftueshëm për detyrat që kryente  
22 policia ushtarake, e drejtë?

23 PË. Po.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani, t'i kthehemi mënyrës  
25 sesi e mbanit kontaktin me komandantin e Brigadës 153. Cila

1 ishte mënyra më e thjeshtë e komunikimit? Çfarë teknologjie

2 përdornit për të qenë në kontakt me të?

3 PË. Kam takuar edhe fizikisht, me telefon edhe me

4 radiolidhje. Ka pasë kohë që edhe përmes ushtarëve të gjallë,

5 përmes korrierëve si ju kemi thënë.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe kur thoni "telefon" e

7 keni fjalën për telefonat satelitor apo për lidhjen telefonike

8 të thjeshtë civile?

9 PË. Lidhjen telefonike satelitore.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Domethënë, ai ka pasë

11 atëherë telefon satelitor, komandanti i Brigadës 153?

12 PË. Nuk e di kohën kur ka ardhë, por, po, ka qenë i pajisur

13 me telefon.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A kanë pasë të gjithë

15 komandantët e brigadave të zonën tuaj telefon satelitor?

16 PË. Në fund në luftë, po.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A e dini se kur i kanë marrë

18 ato telefona?

19 PË. Kanë mujt me i marrë në fillim të vitit 1999 ose fundi i

20 1998.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dje, Gjykatësi Mettraux, ju

22 tregoi disa dokumente, amnisti, urdhra për lirim dhe këto ua

23 kanë treguar dhe palët tjera. Në këto dokumente kishte

24 informacion siç janë data e arrestimit të personit të

25 arrestuar, emri i babait, data e lindjes, adresa dhe kështu me



1 radhë. Kush në zonën tuaj ishte përgjegjës për mbledhjen e  
2 këtij informacioni prej vetë personit të ndaluar, për marrjen  
3 e informacionit prej personit të ndaluar?

4 PË. Ata që e kishin kontaktin e parë me të, policia  
5 ushtarake.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kush ishte përgjegjës për  
7 mbajtjen e evidencës së këtyne të dhënave, për shembull, për  
8 të qenë në gjendje t'i shtypësh ato të dhëna në urdhrin për  
9 lirimin e personit. Kush ishte përgjegjës për mbajtjen e  
10 evidencës?

11 PË. Nuk e di tani rutinën, kush ka qenë kujdestar, ai ka mujt  
12 evidencën. Ka qenë rutinë ditore, kush ka qenë në detyrë, ai e  
13 ka bërë.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nga dëshmia që dhatë më  
15 përpara, kuptova që Nazif Mehmeti ishte një hartues mjaft i  
16 kujdesshëm i dokumenteve, a është kjo e saktë?

17 PË. Të gjithë njerëzit që kanë punu në policinë e Kosovës  
18 kanë qenë me shkollim adekuat në ish-policinë e Jugosllavisë.  
19 Edhe Nazim Mehmeti ka qenë profesor në akademinë policore të  
20 Kosovës në kohën e Jugosllavisë.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Domethënë, mund të  
22 mbështeteshit në të për të mbajtur një evidencë të saktë në  
23 lidhje me të paraburgosurit, a është e drejtë ta them kështu?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do t'i kthehem pyetjes në

1 lidhje me komunikimin. Nga dëshmia, kuptova, që kishit numrat  
2 e telefonit të Shtabit të Përgjithshëm dhe se me këta flisnit  
3 apo kontaktonit përmes telefonit, a është kjo e saktë?

4 PË. Po, ka pasë numra telefoni satelitor komandantët e zonave  
5 dhe Shtabi i Përgjithshëm.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po a ndodhte ndonjëherë të  
7 përdornit rrjetin telefonik civil për të biseduar me anëtarët  
8 e Shtabit të Përgjithshëm?

9 PË. Unë, personalisht, nuk besoj që e kam përdorë ndonjëherë.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Me sa ju kujtohet më së  
11 miri, komandantët e zonave tjera operative a kanë komunikuar  
12 me Shtabin e Përgjithshëm me anë të telefonave satelitor,  
13 domethënë, mesa e dini ju ma së miri?

14 PË. Unë besoj ka qenë rregull me fol me telefonat satelitor.  
15 Personalisht, kam qenë i ngarkuar me një telefon satelitor  
16 edhe e kam përdorë të njëjtin telefon gjithë herët.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani, na i përshkruat  
18 diskutimet me përfaqësuesit e UÇK-së në negociatat e  
19 Rambujesë, ua shprehët shqetësimet drejtpërdrejt. Çfarë  
20 teknologjie përdorët kur folët me përfaqësuesit e UÇK-së në  
21 Rambuje?

22 PË. Telefonin satelitor.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kam nja dy pyetje në lidhje  
24 me mbledhjet e komandantëve të zonave, të cilat me sa e  
25 kuptova nga dëshmia juaj ishin të drejtuara nga Bislim Zyrapi.

1 Kush e përfaqësonte policinë ushtarake në ato takime, pra, të  
2 komandantëve të zonave?

3 PË. Nuk ka pasë komandantë të policisë në mbledhjet me  
4 komandantë të zonave.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po a kishte dikush prej  
6 shërbimit të zbulimit që ishte i pranishëm në atë mbledhje?

7 PË. Jo, z. Gjyqtar.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Me sa kuptova shkurtimisht  
9 ishit anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Kush e përfaqësonte  
10 policinë ushtarake në mbledhjet me Shtabin e Përgjithshëm,  
11 mesa e dini ju ma së miri?

12 PË. Nuk e di. Nuk më kujtohet, po unë me sa ka qenë anëtar i  
13 Shtabit të Përgjithshëm besoj që nuk ka pasë më shumë se një  
14 takim. Edhe ai takim ka qenë i përgjysmuar.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Këto ishin pyetjet e mia për  
16 ju. Faleminderit, z. Mustafa.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
18 çaktivizuar]. Kam disa pyetje, Dëshmitar. Njëra posa doli dhe  
19 tjerat kanë të bëjnë me informacion që ta kuptoj unë më së  
20 miri atë që e thatë.

21 Pak përpara përmendët konferencën e Rambujesë dhe  
22 delegacionin me të cilin folët. A e keni bërë ju vetë këtë  
23 telefonatë me delegacionin dhe keni folë me personin që keni  
24 dashe ta kontaktoni, ju vetë e keni thirr?

25 PË. Po, zotëri.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] dhe cilin e  
2 thirrët me telefon, kush ishte ai person?

3 PË. Unë kam pasë dy njerëz për me të cilët kam komunikue në  
4 Rambuje. Ka qenë Sabri Kiqmari dhe Pleurat Sejdiu.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe pse i  
6 përzgjedhët pikërisht këta dy persona? A i kishit persona të  
7 afërt, veçanërisht të afërt?

8 PË. Unë kam qenë i përfshirë në organizim nga fillimi i  
9 luftës me këta persona. Sabri Kiqmari ka qenë që më ka lidh me  
10 UÇK-në.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kam të  
12 qartë. Pyetje të tjera kanë të bëjnë me temën që ngritët tani  
13 dhe kjo ka të bëjë me vetë fillimin.

14 Çfarë muaji dhe çfarë viti i latë studimet në Prishtinë,  
15 në universitetin e Prishtinës, pra, kur u larguat nga  
16 universiteti?

17 PË. Unë i kam ndërpre -- kam qenë i angazhuar në protestat që  
18 po mbaheshin nga studentët të Universitetit të Prishtinës me  
19 dijen edhe të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Studimet i kam  
20 ndërpre në vitin 1997. Por nga banimi në Prishtinë si student  
21 kam ik në maj të 1998.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Por nuk keni  
23 qenë i pranishëm në ligjërata prej vitit 1997, a është kjo e  
24 saktë?

25 PË. E saktë është.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Domethënë,  
2 përfunduat në atë zonën ku jetonit, që ishte zona e Llapit.  
3 Dhe pyetja ime është kjo. Është një pyetje e hapur. A do të  
4 kishit thënë se zona e Llapit ishte zona më e rëndësishme në  
5 Kosovë gjatë konfliktit?

6 PË. Unë e kam mendu ashtu, meqë ishte në kufi me Serbinë dhe  
7 kishte me vete kryeqytetin e Kosovës, ku ishin të angazhuar të  
8 gjithë ambasadat dhe njerëz ndërkombëtarë që vinin nga jashtë  
9 për të vëzhguar punën tonë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Domethënë, në  
11 vitin 1997, kur ju me shokët u takuat në atë rrugë dhe  
12 vendosët që të organizonit apo të riorganizonit zonën e Llapit  
13 e kam kuptuar drejtë që keni thënë se në atë kohë kishte  
14 përreth 10 anëtarë, përafërsisht 10 anëtarë të UÇK-së në atë  
15 zonë? Ndoshta nuk më kujtohet saktësisht, por mendoj që thatë  
16 kështu se ishit përafërsisht 10 anëtarë të UÇK-së në atë zonë  
17 në atë kohë.

18 PË. Ndoshta kemi folë për 18, për numrin 18, z. Kryetar, se  
19 kemi kanë edhe me numër 10. Por unë e di që në këtë dëshminë  
20 time është përmend numri 18. Dhe ashtu ka qenë rreth fillimit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ju  
22 kundërshtoj në lidhje me këtë. Në qoftë se ai numër ju  
23 kujtohet, ai numër ju kujtohet. Dhe pak mbas kësaj ndodhën  
24 ngjarjet me familjen Jashari dhe numri filloj të rritej i  
25 pjesëmarrësve, a është kjo e saktë?

1 PË. E saktë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atë natë kur  
3 u takove me shokët dhe po e diskutonit të ardhmen e zonës së  
4 Llapit, sa vjeç keni qenë ju?

5 PË. Ishte viti 1997, kam qenë 26 vjeç.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk them se  
7 është diçka gabim në lidhje me këtë, po është diçka shumë e  
8 madhe, domethënë, për të qenë i aftë për ta bërë në atë moshë 26  
9 vjeçare.

10 Domethënë, një vit më pas në verë të 1998, ju  
11 përfundimisht u emëruat komandant i asaj zone. Kjo është e  
12 saktë apo jo?

13 PË. Po.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çfarë përvoje  
15 ushtarake keni pasë para asaj, domethënë, deri në atë moment,  
16 në qoftë se keni pasë?

17 PË. Unë kam pasë përfunduar shërbimin ushtarak në ish-  
18 Jugosllavi dhe kam pasë trajnime të kohës, qoftë në Shqipëri,  
19 qoftë në Kosovë për në lidhje me këto çështje.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Trajnimi,  
21 stërvitjet në Shqipëri, kush ishte përgjegjës për ato  
22 stërvitje?

23 PË. Zakonisht kanë mbajtur oficerët shqiptarë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Por,  
25 asnjëherë nuk keni pasë përgatitje ushtarake për oficerë, apo

1 jo, është kjo e saktë?

2 PË. E saktë është.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe vetë nuk  
4 keni qenë në akademi ushtarake në Jugosllavi sikur si kanë  
5 qenë disa prej shokëve të juaj?

6 PË. Jo. Jo, z. Kryetar. Unë nuk isha pjesë e akademisë  
7 ushtarake.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe, siç  
9 thashë, evidenca e shërbimit qëndron, e dimë që çfarë keni bërë  
10 të bëni gjatë atyre viteve, na thatë që kjo ishte zona më e  
11 rëndësishme në Kosovë. A kishit ndonjë person, një mentor të  
12 cilit i besonit, të cilit i shkonit për këshilla? Ju përmendët  
13 Adem Demaçin. A keni pasë edhe ndonjë person tjetër, ndonjë  
14 mentor tjetër mbi të cilin jeni mbështet rregullisht?

15 PË. Ka qenë Adem Demaçi. Po Adem Demaçi ka qenë i përcjellun  
16 me shumë këshilltarë dhe të gjithë këshilltarët e tij unë i  
17 kam pranuar si të mitë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ma mori  
19 mendja që kjo do të ishte përgjigja juaj. Faleminderit për  
20 përgjigjet. Këto ishin pyetjet që kisha për ju.

21 Znj. Prokurore.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic?

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj leje që të bëj pyetje në  
25 lidhje me pyetjet që i bëni Gjykatësi Mettraux.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Urdhëroni.

2 Vetëm një moment, znj. Lawson.

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ne thjesht duhet të theksojmë që  
4 pyetjet duhet të lidhen vetëm me atë që pyeti Gjykatësi  
5 Mettraux dhe në qoftë se ai ka ngrit ndonjë çështje të re.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet t'i  
7 përmbaheni kësaj.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

9 Pyetje vijuese të palës tjetër nga Z. Misetic:

10 Z. MISETIC: [Përkthim]

11 PY. Z. Mustafa, mirëmëngjesi edhe një herë. Vetëm dua që t'ju  
12 bëj disa pyetje që dalin nga pyetjet që ua bëni Gjykatësi  
13 Mettraux.

14 Grupi i parë i pyetjeve ka të bëjë me këtë pyetje që ka  
15 cekë Mettraux:

16 "Në formimin e njësive të policisë ushtarake në zonën  
17 tuaj operative në fakt ishte zbatimi i udhëzimeve që keni  
18 marrë në lidhje me këtë nga Shtabi i Përgjithshëm. A është kjo  
19 një propozim i saktë?"

20 Dhe ju thatë:

21 "Mund të jetë i drejtë. Mund të thuhet ashtu".

22 Dhe pastaj ju pyeti:

23 "Të jemi të qartë, ju morët një udhëzim prej Shtabit të  
24 Përgjithshëm për krijimin e njësive të policisë ushtarake dhe  
25 e krijuat atë në mënyrë që të përfundonte formimi i tyre, a



1 është kjo e saktë?

2 Dhe ju u përgjigjët:

3 "Po".

4 A ju kujtohet kjo pyetje që jua bëni Gjykatësi?

5 PË. Po, më kujtohet.

6 PY. Kush konkretisht, specifikisht, ju dha udhëzim për të  
7 kriju, formu, njësinë e policisë ushtarake në zonën tuaj?

8 PË. Ne folëm mbi bazën e një dokumenti që m'u sqaru ashtu.

9 Dhe unë e thashë se edhe para atij rekomandimi nga Shtabi i  
10 Përgjithshëm, tek unë ka funksionu policia ushtarake.

11 PY. Kur thoni, "folëm në bazë të një dokumenti që mu tregu" e  
12 keni fjalën për një dokument që ju tregu këtu në këtë gjykim?

13 PË. Po.

14 PY. A ju kujtohet konkretisht për cilin dokument e keni  
15 fjalën?

16 PË. Jo, z. Avokat. Unë s'kam me vete që të mbaj shënim.

17 PY. Atëherë, a duhet të ishte e drejtë të thuhet se përgjigja  
18 jua në pyetjen e Gjykatësit Mettraux bazohet në kujtesën që  
19 keni ju për dokumentin që njëna nga palët këtu ua tregojë në  
20 sallë të gjyqit?

21 PË. Po.

22 PY. Po jashtë këtij dokumenti a keni ndonjë kujtesë ju vetë,  
23 të keni marrë ndonjë udhëzim prej Shtabit të Përgjithshëm për  
24 të kriju njësinë e policisë ushtarake?

25 PË. Ju kam thënë për sajten herë që jo.

1 PY. Tani ju kërkoj që të përqendrohemi tek pyetjet që ua bënë  
2 në lidhje me qendrat e ndalimit.

3 Gjykatësi Mettraux në faqen 102, 104 të transkriptit të  
4 djeshëm, ju pyeti:

5 "...kishte një urdhër të përgjithshëm për arrestimin e  
6 personave që dyshoheshin se ishin bashkëpunëtorë nga Shtabi i  
7 Përgjithshëm. A e kam këtë e kam kuptuar drejt?"

8 Dhe pastaj pyet:

9 "Edhe njëra nga gjërat që Shtabi i Përgjithshëm kërkoi  
10 nga ju ishte që të krijonit objektet e ndalimit për këta  
11 persona. Është kjo e saktë?"

12 Përgjigj juaj ishte:

13 "Kishim shtëpinë e ndalimit edhe përpara një urdhri apo  
14 udhëzimi apo rekomandimi sido që ta quani".

15 Gjykatësi pastaj ju pyeti apo sot, ju urdhëruan që "të  
16 gjenit vendet e përshtatshme për shtëpi të tilla të ndalimit",  
17 a është kjo e saktë?

18 Dhe më pas thotë:

19 "Përveç këtyre udhëzimeve ju dhanë edhe udhëzime sesi t'i  
20 drejtoni apo udhëhiqni këto objekte".

21 Dhe përgjigja juaj ishte:

22 "Rekomandimet ishin ato që i lexuam. Nuk kishte të  
23 tjera".

24 Gjykatësi Mettraux pastaj tha:

25 "Po i përdori fjalët e juaja, zotëri. Shtabi i

1 Përgjithshëm dha udhëzime të përgjithshme në lidhje me mënyrën  
2 sesi duhet të drejtoheshin këto objekte të ndalimit, a mund të  
3 përgjigjeni me po ose jo?"

4 Dhe përgjigja ishte:

5 "Po, i lexuam ato sot këtu".

6 Dua të jemi krejtësisht të qartë në lidhje me këtë z.  
7 Mustafa. A i kam interpretuar përgjigjet që ia dhatë  
8 Gjykatësit Mettraux drejt se udhëzimet e përgjithshme për  
9 ndalimin e bashkëpunëtorëve, juve ju referuat dy dokumenteve  
10 që unë jua tregova gjatë pyetjeve të mia të cilat janë provat  
11 1D29 dhe 1D30 dhe që janë urdhrat e z. Zyrapit drejtuar jush  
12 dhe komandantëve tjerë të zonës, a është kjo e saktë?

13 PË. Po, e saktë. Mbi ato dokumente ne folëm.

14 PY. Kur ju përgjigjët pyetjeve të Gjykatësit Mettraux dhe  
15 thatë, ju dhanë udhëzime për të krijuar objekte ndalimi dhe  
16 për të gjetur objekte të përshtatshme ndalimi dhe ju  
17 përgjigjët në formë pohore, ju thatë:

18 "Rekomandimet ishin ato që lexuam.

19 "...i lexuam sot këtu".

20 Edhe njëherë, po i referoheni dy dokumenteve që pamë, që  
21 konkretisht janë urdhëresat apo rekomandimet nga z. Zyrapit, që  
22 konkretisht kanë numrat e provave materiale 1D29 dhe 1D30, për  
23 këto dokumente e kishit fjalën?

24 PË. Pikërisht, z. Avokat. Unë për ato dokumentet që më  
25 servohen këtu, unë për ato flas.

1 PY. Që të jemi të qartë. Në transkriptin në faqen 104,  
2 rreshtat 16 dhe 17. Vazhdon përgjigja juaj, përveç këtyre dy  
3 urdhëresave, "nuk kishte urdhëresa të tjera".

4 A është kjo dëshmia juaj?

5 PË. Po.

6 PY. Flasim për komunikatat për të cilat ju drejtoj pyetje  
7 Gjykatësi Mettraux. Ju bënë pyetje lidhur me dy amnisti - një  
8 e lëshuar në dhjetor, 31 dhjetor dhe ka numrin e provës  
9 materiale P00225 dhe tjetra 17 janar - dhe pretendohet se janë  
10 lëshuar bazuar, ndër të tjera, mbi komunikatat e Shtabit të  
11 Përgjithshëm. Ju kujtohen pyetjet që ju bëri Gjykatësi  
12 Mettraux lidhur me këto?

13 PË. Po.

14 PY. Tani që jeni këtu, a mund të evidentoni ndonjë komunikatë  
15 të vetme apo deklaratë politike të UÇK-së që ju mund ta keni  
16 interpretuar si një amnisti për të ndaluarit shqiptarë të  
17 Kosovës?

18 PË. Jo, s'më vjen në mend.

19 PY. Dëshmitar, unë po ju them që arsyeja pse nuk ua treguan  
20 këto komunikata apo deklarata politike është se nuk  
21 ekzistojnë. Keni ndonjë arsye që ta kundërshtoni këtë që sapo  
22 thashë?

23 PË. Nuk kam arsye të kundërshtoj, jo s'u kundërshtoj.

24 PY. Po ashtu lidhur me komunikatat ju drejtuan pyetje, që  
25 është reflektuar në faqen 112 të transkriptit të djeshëm, ju

1 pyetën lidhur me një deklaratë që i kishin dhënë ZPS-së ku

2 keni thënë:

3 "...komunikata jepte leje për t'u marrë me personat që  
4 pengonin punën e UÇK-së".

5 Gjykatësi Mettraux pyeti a i qëndroni kësaj deklaratë dhe  
6 ju u përgjigjët: "Po...".

7 Ju kujtohet?

8 PË. Po. Ka qenë edhe ajo. Dhe ajo ka mujt me qenë mbështetja  
9 jonë, po unë s'kam fol specifikisht.

10 PY. Kjo do të ishte pyetja ime e radhës në fakt. Cila  
11 komunikatë konkrete ju jepet "ju leje të merreshit me personat  
12 që pengonin punën e UÇK-së"?

13 PË. Jo, s'kam fol specifikisht ju thashë. Ju thashë në  
14 përgjithësi ka mujt me kanë arsye. Por ne arsye kryesore kemi  
15 pasë arsyet ushtarake, këtë e kam cekë sa herë në dëshminë  
16 time.

17 PY. Kur thoni "në përgjithësi edhe mund të ketë qenë  
18 arsyeja", çfarë do të thotë kjo?

19 PË. Nëse ka pasë diçka nëpër komunikata, ne i kemi shfrytëzu  
20 ato. Por unë nuk i di specifikisht që ka.

21 PY. Pra, nuk ju kujtohet ndonjë komunikatë specifike që t'ju  
22 jepte ju leje, po përdorë këtë formulim, kështu, nuk ju jepte  
23 lejen për ta bërë këtë?

24 PË. Po.

25 PY. Përdorimi i fjalës "leje". Ju keni dhënë dëshmi në formë

1 të hollësishme që ju keni qenë autoriteti më i lartë në zonën  
2 tuaj dhe se nuk kishte autoritet brenda UÇK-së që qëndronte  
3 mbi ju. Pse do ju nevojitej ju leje nga ndokush që të  
4 merreshit me personat që pengonin punën e UÇK-së?

5 PË. Nuk kam kërkuar leje.

6 PY. A kishit nevojë ama për leje nga ndokush që të ndalonit  
7 personat që ju besonit se pengonin punën e UÇK-së?

8 PË. Unë besoj se e kam bërë të qartë këtë, që, jo, s'kam marrë  
9 se s'kam pasë nevojë për të marrë leje nga askush.

10 PY. Pyetja ime e fundit po ashtu lidhur me pyetjet që bëri  
11 Gjykatësi Metraux kur ju pyeti nëse pranoni se ishit në varësi  
12 të Shtabit të Përgjithshëm dhe ju thatë se, po, e pranoni.

13 Në vitin 1998, ndonjë person nga Shtabi i Përgjithshëm a  
14 ju dha ndonjë urdhëresë të cilën ju kërkuar ju ta zbatoni, ta  
15 ekzekutoni?

16 PË. Ato urdhënesa, rekomandime për të cilat kemi fol prej si  
17 jemi këtu, ato kanë ardhë nga Shtabi i Përgjithshëm, Bislir  
18 Zyrapit, shefi i shtabit.

19 PY. Pra, sa i takon marrëdhënies së vartësisë, fillimisht, po  
20 flisni, lidhur me dokumentet apo çfarëdo materiali që keni  
21 marrë nga Bislir Zyrapit, e saktë?

22 PË. Unë po flas nga dokumentet që i kam.

23 PY. Dokumentet që kemi parë në këtë gjykim?

24 PË. Po.

25 PY. Kam nevojë të kuptoj më qartë këtë punën e marrëdhënies

1 së varësisë. Përmendët Bislīm Zyrāpin. Bislīm Zyrāpi është një  
2 person që ju e emëruat në shkurt, e ngritët në detyrë si  
3 komandant të përgjithshëm të UÇK-së, saktë?

4 PË. Jo, komandant të përgjithshëm e kemi ngrit Sylejman  
5 Selimin.

6 PY. Po, kështu e përfundoj. Ramush Haradinaj propozoi  
7 Sylejman Selimin dhe ju propozuat Bislīm Zyrāpin, saktë?

8 PË. Po.

9 PY. Tani thelbi im është ju mendonit se kishit autoritetin që  
10 ta propozonit këtë person që të emërohej, saktë?

11 PË. Po.

12 PY. Unë besoj, se po e kuptoni, që është e pazakontë për ne  
13 të perëndimit që një vartës të emërojë eprorin e vet për  
14 ngritje në detyrë. A e kupton këtë që po përpiqem të them?

15 PË. Gjithë themelimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe  
16 mënyrat e kujdesit ndaj saj ka qenë të vështirë ta

17 paramendojnë njerëzit që vijnë nga shtetet me rregullim  
18 tjetër. Ne i kemi bërë ato që kemi ditë, ato që mund. Shtabin e  
19 Përgjithshëm ne kemi dashtë me vu në ballë të vetes. Ne vetë  
20 kemi qenë të interesum ta emërojmë një Shtab të Përgjithshëm  
21 që kishte me na përfaqësue tutje në luftë dhe politikat e  
22 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nuk mbaj mend asnjë urdhër  
23 personalisht që më është dhënë nga dikush.

24 PY. Pyetja ime është, dua t'i shpjegoni Trupit Gjykues, çfarë  
25 deshët të thonit kur thatë po e pranoj që kam qenë në varësi

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04746 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 32

1 të Shtabit të Përgjithshëm. Në çfarë kuptimi është kjo varësi?

2 PË. Varësi e koordinimit. Koordinim zonash e bënte shefi i

3 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.

4 PY. Faleminderit për kohën dhe për përgjigjet tuaja.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit dhe Kryetarit të

6 Trupit Gjykes për lejen. Kam edhe disa çështje organizimi për

7 sa i takon pranimit të dokumenteve, po s'është nevoja të jetë

8 dëshmitari për këtë. Faleminderit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

10 Z. Emmerson.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Edhe unë kam disa fusha që dua të

12 mbuloj.

13 Pyetje vijuese të palës tjetër nga Z. Emmerson:

14 Z. EMMERSON: [Përkthim]

15 PY. Së pari, dua t'ju pyes lidhur me një numër pyetjesh dhe

16 përgjigjesh të gjykatësit Mettraux. Po shoh faqen 122 të

17 transkriptit të djeshëm dhe po filloj me rreshtin 4 e në

18 vijim.

19 Do t'ju lexoj pyetjet dhe përgjigjet, pra, pyetjet e

20 Gjykatësit Mettraux dhe përgjigjet që ju dhatë dje pasdite

21 lidhur me një deklaratë dëshmitari që i është dhënë ZPS-së

22 konkretisht nga z. Mehmeti.

23 Ju kujtohet Gjykatësi Mettraux ju tregoj disa gjëra

24 lidhur me dëshminë e z. Mehmeti dhe ju pyeti nëse kishit

25 ndonjë arsye për ta kundërshtuar? Ju kujtohet që



1 ndodhi dje?

2 PË. Po.

3 PY. Unë do ju lexoj që ta kem edhe në transkript në mënyrë që  
4 ta ndiqni, po nuk është nevoja që ta shfaqni në ekran.

5 Pyetje, nga Gjykatësi Mettraux, rreshti 4:

6 "Më lejoni t'ju tregoj një deklaratë dhe mund të  
7 komentoni për të, nëse dëshironi. Sërish është nga shefi i  
8 policisë ushtarake tuajin, z. Mehmeti. Atë e pyetën për këtë  
9 temë".

10 Do ta shohim pak më vonë për çfarë bëhet fjalë.

11 "Pra, e pyetëm për këtë temë. Është 055535-TR-ET Pjesa 5,  
12 faqja 6 dhe 7 dhe Pjesa 7 te shqipja, po unë po ua lexoj".

13 Në këtë fragment, në këtë pjesë, nuk ua treguan në ekran  
14 dokumentin. Po ju lexuan një paragraf të shkurtër dhe vazhdon  
15 kështu. Gjithmonë flasim për pjesën e Gjykatësit Mettraux:

16 "Ai", Mehmetaj" e pyeti?

17 "Kur anëtarët e mbrojtjes civile sillnin persona të  
18 tillë, a kishte ndonjë procedurë për të verifikuar nëse e  
19 kishin bërë urdhrin për të vepruar kështu?"

20 "Ju jeni përgjigjur:

21 "'Kjo ka qenë detyra e SHIK-ut'".

22 Dhe shton Gjykatësi Mettraux:

23 "Pra, z. Mehmetaj, mirë a keq, duket se bëhet fjalë për  
24 shërbimin sekret apo informativ që ka qenë përgjegjës për  
25 verifikimet".

1 Ju thoni:

2 "Nuk dua të komentoj deklaratën e tij".

3 Gjykatësi Mettraux vazhdon:

4 "Po a pajtoheni me të, zotëri?"

5 Ju përgjigjeni:

6 "Burimet e informacionit për personat që trajtoheshin në  
7 zonë. Banorët, për të gjithë banorët, të gjithë anëtarët e  
8 policisë e UÇK-së duhet të ishin vigjilentë të identifikonin  
9 kush jetonte afër vijës së frontit. Të gjitha personat që kemi  
10 mbajtur të ndaluar jetonin diku në afërsi të vijës së  
11 Mbrojtjes..."

12 Tani, unë dua që të shohim konkretisht të gjithë  
13 deklaratën apo fragmentin konkret të z. Mehmetaj sepse nuk ua  
14 treguan ju në ekran që ta lexonit.

15 Dhe kjo nuk është në listën e asnjë prej pjesëmarrësve,  
16 kjo sepse Gjykatësi Mettraux e ka marrë këtë material diku  
17 tjetër dhe nuk ka qenë e paraqitur në listë, prandaj unë do  
18 kërkoj që të vendoset në ekran një transkript që nuk ka qenë  
19 në listën e materialeve të asnjë prej pjesëmarrësve.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Transkripti i  
21 kujt?

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Është transkripti i një  
23 interviste të z. Mehmetaj me ZPS-së dhe Gjykatësi Mettraux  
24 bëri një pyetje të një transkripti që nuk ka qenë në listën e  
25 materialeve të asnjë prej pjesëmarrësve. Prandaj ne nuk kishim

1 mundësi të bënim kundërpyetje për një dokument që ne nuk e  
2 kishim parë më përpara por që Gjykatësi Mettraux vendosi ta  
3 përdorte sidoqoftë.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po unë nuk bëra  
5 kundërpyetje, z. Emmerson. Unë i bëra pyetje.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po çështje interpretimi është kjo  
7 atëherë.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Emmerson, nuk është  
9 çështje interpretimi.

10 Për t'ju përgjigjur pyetjes suaj, unë nuk jam, nuk po bëj  
11 kundërpyetje. S'po argumentoj. Nuk dua të diskutoj me ju. Në  
12 qoftë se doni ta shfaqni dokumentin, shfaqeni dokumentin në  
13 ekran.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po e vlerësoj këtë gjë. Është  
15 dokumenti 055535-TR-ET Pjesa 5, faqja 6, rreshti 19.

16 PY. Ky ka qenë fragmenti që ju lexoi Gjykatësi Mettraux

17 "PY. Në rregull. Vazhdojmë pjesa tjetër ..."

18 Kjo është pyetja që i ka bërë Prokuroria z. Mehmetaj kur  
19 i ka dhënë intervistë ZPS-së dhe këtë ua tregoj Gjykatësi  
20 Mettraux dhe tha që kjo ka qenë dëshmia e z. Mehmetaj dhe ju  
21 kërkoi të komentoni lidhur me të. Ai ju lexoi këtë:

22 "Në rregull. Vazhdojmë. Pjesa tjetër:

23 "'Kur anëtarët e mbrojtjes civile sillnin persona të  
24 tillë, a ka pasë ndonjë procedurë për të verifikuar ku e  
25 gjetën urdhrin për ta bërë këtë?'

1 "Përgjigje:

2 "'Ka qenë detyrë e SHIK-ut'.

3 "Tani, është kjo e saktë?"

4 Pyetje e Prokurorisë kjo. Të njëjtën pyetje që bëri dhe  
5 Gjykatësi Mettraux: A është e saktë? Dhe përgjigja është:

6 "Kështu duhet të kishte qenë. Unë konfirmoj se detyrat  
7 për shërbimin e inteligjencës përfshinin këtë. Por deri në  
8 ç'masë e bënin, unë nuk e di".

9 A ka ndonjë gjë në dëshminë e plotë të z. Mehmetaj të  
10 cilën e ju e kundërshtoni apo për të cilën doni të jepni  
11 komente?

12 PË. Nuk kam koment. Është mendim i Nazif Mehmetit. Unë po ju  
13 them të drejtën për Nazif Mehmetin dhe Latif Gashin kemi qenë  
14 në proces bashkë. Dhe sa herë flitet për ta, unë i synoj  
15 fjalët që i kam dëgjue nga ata, nga këta të dy. Unë ju besoj  
16 të dyve dhe për atë nuk hyj në mesin e tyre. Mundet me kanë  
17 ndonjë keqinterpretim. Nuk e di.

18 PY. Por a pajtoheni me mua kur them që ata që u lexoj  
19 Gjykatësi Mettraux, ishte që SHIK-u ka përgjegjësi për atë  
20 funksion, por kjo nuk pasqyron tërësisht çfarë ka thënë në  
21 intervistë në qoftë se e shohim tamam kontekstin?

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk besoj se pyetja është e  
23 përshtatshme. Intervista është e qartë. Edhe dëshmitari nuk  
24 mund të shtoj asgjë lidhur me këtë intervistë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni

1 çaktivizuar].

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Pyetja ime është kjo: Gjykatësi  
3 Mettraux përzgjodhi një ekstrakt të intervistës që nuk e  
4 përfshinte të gjithë tekstin. Tani që e pe të gjithë tekstin,  
5 a pajtoheni që nuk ka pasur asgjë mes jush dhe tij sepse as  
6 atij nuk i kujtohet saktësisht se çfarë ndodhte sa i takon  
7 SHIK-ut?

8 PË. Po, z. Avokat. Mua këtu më është pyet për pjesë të  
9 deklaratave dhe më herët, por e di që deklarata në përgjithësi  
10 s'ka asgjë që unë do ta kundërshtoja.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kur përdora termin  
12 "kundërpjetje", Gjykatësi Mettraux, për këtë e kisha fjalën.  
13 Që t'ua shpjegoj --

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk kemi nevojë për  
15 komentet tuaja, z. Emmerson. Keni bërë disa komente të  
16 papërshtatshme. Z. Emmerson, bëni pyetjet tuaja.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po unë s'kam mbaruar, do vazhdoj.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk kam nevojë për  
19 komentet tuaja. Kam nevojë për pyetjet tuaja dhe për  
20 përgjigjet e dëshmitarit. Nuk është ky vendi për t'i bërë  
21 këto, z. Emmerson.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim]

23 PY. Vazhdojmë me këtë temë, me temën e SHIK-ut, të sqarojmë  
24 disa aspekte nëse mundemi, sepse ju ka bërë disa pyetje  
25 Gjykatësi Mettraux dhe Gjykatësi Barthe deri diku për SHIK-un

1 dhe shërbimin informativ atë të zbulimit se çfarë ishin.

2 Të jemi të qartë. Së pari, a pajtoheni me sugjerimin se  
3 para riorganizimit të UÇK-së në vijim të ofensivës së  
4 shtatorit, nuk kishte funksion inteligjence pranë Shtabit të  
5 Përgjithshëm? Pra, hera e parë, që u krijua një shërbim  
6 inteligjence në nivelin e Shtabit të Përgjithshëm ishte pas  
7 riorganizimit që është pas ofensivës së shtatorit, ka filluar  
8 pas ofensivës së shtatorit?

9 PË. E saktë.

10 PY. Unë po ju propozoj se nëntori është periudha kur për herë  
11 të parë Shtabi i Përgjithshëm krijoi një post, nëntori 1998,  
12 pra, u krijua një post lidhur me shërbimet e inteligjencës. Ju  
13 kujton gjë kjo? Është e drejtë të themi nëntor?

14 PË. Nuk më kujtohet koha, z. Avokat.

15 PY. Po nuk duam të fokusohemi shumë te data, ama a pajtohemi  
16 që ka ndodhur pas riorganizimit?

17 PË. Unë besoj që ashtu ka ndodhur.

18 PY. Edhe periudha më e hershme që mund të ketë ndodhur kjo,  
19 ka qenë duke filluar nga tetori dhe më pas në nëntor, sepse  
20 ofensiva ka ndodhur në shtator dhe riorganizimi filloj në  
21 tetor, a është e drejtë?

22 PË. E drejtë. Ashtu është.

23 PY. Pra, çdo referencë që i bëhet SHIK-ut apo shërbimit të  
24 inteligjencës më përpara kësaj periudhe mund të ketë qenë  
25 lidhur me nivelin operativ në nivel zone, e drejtë?

1 PË. Po.

2 PY. Dhe ju na thatë se aso kohe mes tetorit dhe marsit ndër  
3 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm që ju e dinit që nuk ishin  
4 në Kosovë gjatë gjithë kësaj periudhe një nga këta persona  
5 ishte z. Veseli, e drejtë? Këta na e thatë dje.

6 PË. Po.

7 PY. Edhe ai ishte caktuar në këtë rol të shërbimin informativ  
8 pranë Shtabit të Përgjithshëm pas riorganizimit. E dinit këtë  
9 apo nuk e dinit?

10 PË. Nuk më kujtohet tash saktë se është thënë, kam mujtë edhe  
11 mos me e ditë.

12 PY. Ama e dinit se ai, nga tetori e deri në mars, ka qenë  
13 jashtë Kosovës, sepse na e thatë?

14 PË. Unë nuk kam thënë se cilën herë ka qenë jashtë. Ka mujt  
15 me qenë jashtë. Ai ka qenë shumicën e kohës jashtë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,  
17 nuk besoj se Gjykatësi Mettraux i bëri një pyetje të ngjashme.  
18 Po dilni përtej.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo, është një pyetje lidhëse kjo  
20 për të dalë pikërisht tek pyetja që bëri Gjykatësi Mettraux.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë ju  
22 lutem kufizohuni tek pyetjet që ka bërë Gjykatësi.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po çdo gjë që lidhet me SHIK-un  
24 është relevante për shkak të periudhës.

25 PY. Gjykatësi Gaynor ju bëri pyetje për telefonat satelitorë

1 si një formë komunikimi dhe u përgjigjët se kur komunikoni me  
2 Shtabin e Përgjithshëm, ju i kontaktoni me telefon satelitor,  
3 kështu?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe përmendët dy personat me të cilët komunikoni,  
6 veçanërisht gjatë Rambujesë, por nuk na intereson kjo për  
7 momentin. Ajo që dua të kuptoj unë është sa telefona satelitor  
8 kishit ju si komandant i zonës së Llapit apo kishte zona e  
9 Llapit?

10 PË. Ka mund të jetë katër, pesë.

11 PY. I përdornin persona të ndryshëm në zonë apo i  
12 kontrollonin ju të gjithë?

13 PË. Komandantët e brigadës dhe unë.

14 PY. Gjatë asaj kohe si komandat i zonës, a keni bërë ju, a  
15 keni thirr ndonjëherë në telefon apo ju ka thirr ndonjëherë në  
16 telefon Kadri Veseli? Kur kishit telefona satelitor, unë po  
17 them që ju asnjëherë të vetme nuk keni bisedu me Kadri  
18 Veselin, e drejtë, me telefon?

19 PË. E drejtë është.

20 PY. Kadri Veseli apo ndonjë person tjetër nga Shtabi i  
21 Përgjithshëm a ka dhënë ndonjëherë udhëzime për ndonjë person  
22 në zonën tuaj, të arrestonin ndonjë person me emër?

23 PË. Jo, zotëri.

24 PY. Me sa dini ju ndonjë person në zonën tuaj, a ka informuar  
25 ndonjëherë Shtabin e Përgjithshëm lidhur me personat që ishin



1 arrestuar?

2 PË. Mesa di unë, jo.

3 PY. Nëse dikush keqtrajtohej, sepse e dimë që ka ndodhur,  
4 rreth tetë persona të paktën në Llapashticë për periudhën që  
5 flasim ne, pra, në qoftë se një person keqtrajtohej a lëndohej  
6 gjatë arrestimit, a është ky një lloj informacioni që do ua  
7 jepnit me telefon satelitor Shtabit të Përgjithshëm, do i  
8 thonit që X person është mavijosur a është rrahur nga stafi  
9 im, a do ja jepnit ju këtë informacion Shtabit të  
10 Përgjithshëm?

11 PË. Ju thashë edhe më herët që Shtabi i Përgjithshëm s'ka  
12 pasë informata nga zona ime për këtë punë.

13 PY. Faleminderit.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kaq pyetje kisha.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts.

16 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kam pyetje shtesë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

18 Alagenda.

19 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Vetëm një pyetje.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

21 Pyetje vijuese të palës tjetër nga Znj.

22 Alagenda:

23 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

24 PY. Kjo ka lidhje me pyetjen që bërë i Trupi Gjykses, mesa  
25 dini ju a ka ekzistuar ndonjë dokument a është marrë ndonjë

1 urdhëresë nga Shtabi i Përgjithshëm ku urdhërohej keqtrajtimi  
2 dhe ndalimi i civilëve?

3 PË. Jo, znj. Avokate.

4 PY. Faleminderit.

5 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Kaq kisha.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
7 znj. Alagendra.

8 Ka gjë tjetër për të shtuar në këtë pikë.

9 Dëshmitar, do ju bëhet qejfi të dëgjoni tani që  
10 përfundam me dëshminë tuaj.

11 Ka diçka nga palët?

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Emmerson kishte harruar  
13 mikrofonin ndezur.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit  
15 që kaluat këtë javë me ne. Urojmë të jeni mirë. Tani mund të  
16 largoheni. Dhe faleminderit. Sekretarja do të shoqërojë jashtë  
17 sallës së gjyqit.

18 DËSHMITARI: Faleminderit juve.

19 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

20 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
22 çaktivizuar] Keni çështje organizimi.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

24 Do të doja të kërkoja të pranoheshin si prova shënimet e  
25 13 shkurtit 1999 që takimet me komandantët e zonave që është

1 SPOE0022328 deri në SPOE00226365, në të dyja gjuhët.

2 Faleminderit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtime.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
6 çaktivizuar]. Vendosini numrin e provës materiale, ju lutem.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Merr numrin e provës  
8 materiale 1D33.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
10 çaktivizuar].

11 Z. LAWS: [Përkthim] Të premtën në 14 korrik, bëra një  
12 urdhër me gojë që ishte konfidencial dhe u bë në seancë  
13 private. A mund të kërkojmë të dali versioni i redaktuar  
14 publik i urdhrit?

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër.

16 Z. Emmerson.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ka dy aspekte që dua të  
18 parashtroj para se të vijë dëshmitari i radhës. Një lidhet me  
19 kërkesën nga Mbrojtja e Veselit për një urdhër me gojë sa i  
20 takon parametrave që trajtojnë masën deri ku mund t'i  
21 kundërshtojnë avokatët pyetjet e Trupit Gjykses, sepse gjatë  
22 kohës që po kundërshtoja pyetjet e Gjykatësit Mettraux, u bënë  
23 disa konstatime deri në momentin sa më të ulës.

24 Në juridiksionin nga vij unë, është detyra e avokatëve të  
25 kundërshtojnë pyetjet tendencioze të palëve përfshirë dhe të

1 Trupit Gjykses. Nëse nuk pranohet në këtë juridiksion, unë do  
2 të doja të dilte një vendim ku të bëhet e qartë pse nuk  
3 lejohen kundërshtimet.

4 Sikurse e kuptoni, është detyrimi im profesionist të kem  
5 parasysh situatën. Dhe të kem pikëpamjet e mia profesionale  
6 dhe pikëpamjet e mia profesionale janë të tilla, se kam qenë  
7 edhe pjesë e Trupit Gjykses, por kam qenë dhe avokat. Kanë  
8 qenë disa pyetje të Gjykatësit Mettraux dhe të Gjykatësit  
9 Barthe, ku u cenuan kufijtë legjitim të sjelljes së  
10 përshtatshme të një Trupi Gjykses. Sigurisht, do të jetë bazë  
11 apeli kjo në të ardhmen dhe kjo nuk është herë e parë.

12 Por përpiqem t'ju them që duhet të dilni me një vendim,  
13 sepse unë do të bëj një apel, në qoftë se nuk pranohen  
14 kundërshtimet, nesër, pasnesër do thonë "Pse nuk e  
15 kundërshtuat kur ishte momenti?" Nëse unë kundërshtoj,  
16 Gjykatësi Mettraux më dha urdhër të ulesha. Dhe u përpoq të  
17 hynim në një diskutim dhe ju më thatë që të ulesha. Dhe  
18 kundërshtimi im që u bë shumë i qartë është hequr nga  
19 transkripti sepse po flisnim në të njëjtën kohë.

20 Thjesht po ju them nuk dua që të shkojmë, nuk duam të  
21 degjenerohet situata, po të duhet të kemi një proces të qartë.  
22 Nëse gjykatësit janë të përgatitur për kundërpjetje dhe ju  
23 kërkoi falje pse përdora këtë term, e pamë që kjo e orientoi  
24 në mënyrë të gabuar dëshmitarin, doli jashtë kontekstit, është  
25 detyrimi profesional ta kundërshtoj.

1 Dhe në qoftë se Trupi Gjykses është i qëndrimit që unë  
2 nuk duhet ta bëj, atëherë duhet të dilni me vendim lidhur  
3 me --

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dikush tjetër  
5 a ka diçka për të shtuar?

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk kishte asgjë të  
7 papërshtatshme në pyetjet e Gjykatës. Ato ishin pyetje në  
8 lidhje me çështje relevante që lidheshin me dijeninë e  
9 dëshmitarit lidhur me dëshminë që çështjet për të cilat  
10 dëshmoi ai.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kemi asnjë gjë tjetër për të  
13 thënë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë do të  
15 na duhen disa minuta për dëshmitarin e ardhshëm. A do të kenë  
16 ndryshim përfaqësuesit e Prokurorisë?

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po. Do të ketë. Po kam dy  
18 kërkesa, e para ka të bëjë me shtimin e numrit të lejuar të  
19 fjalëve. Jemi në proces të paraqitjes të mocionit sipas  
20 rregullës 155. Ka të bëjë me tetë dëshmitarë dhe për të  
21 paraqitur një mocion të konsoliduar të përbashkët për të  
22 gjithë këta dëshmitarë do të na duhen një zgjatje apo shtim i  
23 fjalëve me 12.000 fjalë.

24 Ne jemi konsultuar me përfaqësuesit e Mbrojtjes dhe të  
25 Viktimave dhe ata nuk kanë kundërshtim në lidhje me kërkesën

1 tonë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë e  
3 pranojmë kërkesën tuaj dhe miratohet shtimi i fjalëve deri më  
4 12.000 fjalë.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit.

6 Çështja e dytë ka të bëjë me kohën e përafërt që ju duhet  
7 Mbrojtjes për kundërpyetjet. Ne mirëpresim zvogëlimin e kohës,  
8 mirëpo kjo kohë duhet të jetë e parashikueshme për avokatët e  
9 mbrojtësit sepse pasojat janë këto.

10 Ka pasoja logjistike. Humbet kohë në sallë të gjyqit.  
11 Dëshmitarët kanë detyrime në jetën e tyre të përditshme, në  
12 punë, familje e kështu me radhë dhe për të bërë të gjitha këto  
13 aranzhime duhet të jenë ato kohëra më të apo përllogaritje të  
14 kohës nevojshme më të sakta.

15 Në bazë të këtyre kohërave të përafërta që janë dhënë nga  
16 Mbrojtja, parashikoj që Dëshmitari 03879 do ta mbushë javën e  
17 parë mbas pushimit të Gjykatës. Dhe për sa i përket bllokut  
18 apo grupit të ardhshëm të dëshmitarëve ndoshta duhet që të  
19 rishikohet kjo përllogariste e kohës në mënyrë që planifikimi  
20 të bëhet siç duhet.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka diçka  
22 tjetër? Dikush prej palëve.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Ne i kemi  
24 kërkuar ZPS-së, në fakt, në lidhje me bllokun e ardhshëm të  
25 dëshmitarëve dhe radhitja e tyre është si mbas radhitjes që do

1 të ftohem për të dhënë dëshmi. Dhe ju kemi kërkuar atyre, në  
2 fakt, që të na e bëjnë të ditur atë radhitje.

3 Ne e kemi të vështirë të planifikojmë në bazë të listës  
4 së ZPS-së që jepet.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Padyshim që  
6 duhet të ketë bashkëpunim mes palëve dhe ne e kemi kërku prej  
7 palëve këtë bashkëpunim.

8 E kemi parasysh atë që e tha Prokurorja, sepse ne  
9 vazhdimisht duhet që t'i rishikojmë dhe ndryshojmë  
10 përlllogaritjet e kohës që na nevojitet. Pjesë e një problemi  
11 është se, ekipi juaj fillon dhe jep një kohë goxha të gjatë të  
12 për afërt që do t'i duhet pastaj vazhdon z. Roberts, znj.  
13 Alagendra dhe është e vështirë të vazhdohet me të njëjtat  
14 pyetje.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Edhe unë e kam të njëjtin koment  
16 për ta bërë. Është e kuptueshme që ekipet duhet t'i rishikojnë  
17 dhe ndryshojnë përlllogaritjet e tyre të kohës.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për këtë  
19 duhet të diskutojnë palët mes vetit dhe ekipet mbrojtëse mes  
20 veti. Ju kërkoj, inkurajoj, që ta bëni këtë. Të paktën do të  
21 zvogëlohet problemi edhe pse nuk do të eliminohet tërësisht.

22 Urdhëroni, z. Misetic.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë kam menduar për këtë gjatë  
24 ujkendit. Dëshmitari i fundit që kishim ishte shumë i  
25 përqendruar në përgjigjet dhe në mënyrat si i dha ato.

1 Si rezultat i asaj unë i shkurtova edhe pyetjet e mia  
2 edhe kohën që më nevojiteshe për të. Në këtë mënyrë dua ta  
3 ilustrojë se koha që përlllogarisim varet nga dëshmitari,  
4 mënyra si përgjigjen e kështu me radhë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.  
6 Z. Roberts.

7 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po edhe duke marrë parasysh ato që  
8 thanë kolegët e mi edhe pyetjet e mia apo koha që thashë që do  
9 të më duhej u zvogëlua në zero. Unë do ta kem parasysh këto që  
10 e thamë të gjithë këtu në të ardhmen kur të bëj përlllogaritjet  
11 e kohës që do të na duhen me dëshmitarët e prokurorisë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Diskutimi,  
13 bashkëpunimi ndihmon më së shumti në këtë drejtim.

14 Tani do të bëjmë një pushim të shkurtër dhe do të  
15 kthehemi mbas dhjetë minutash.

16 --- Pauza fillon në orën 10.34.

17 --- Seanca rifillon në orën 10.44

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Prokuror,  
19 e keni fjalën ju.

20 Z. BAARLINK: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.  
21 Kemi Dëshmitarin 2153.

22 Përpara sesa të vij dëshmitari në sallën e gjyqit, e di  
23 që ZPS-ja ka parashtruar një version të paredaktuar të  
24 deklaratës së ZPS-së, për numër identifikimi është ERN 114301  
25 deri në 114316-F1664. Ky është versioni i paredaktuar i



1 nënshkruar të 076841 deri në 076856 dhe është nxjerrë si pjesë  
2 e paketës 861. Ne këtë e mbështesim në rregullën 154 në  
3 parashtrim që kemi bërë sipas rregullit 154 dhe në postën  
4 elektronike të palëve të dërguara të dielën. Ky version  
5 gjithashtu ka edhe redaktimet të cilat janë urdhëruar nga ju  
6 të nderuar Gjykatës.

7 Ky dëshmitar do të japë dëshmi në seancë publike,  
8 megjithatë për shkak që dy emrave të cilat përmbahen në  
9 deklaratën e ZPS-së dhe për të cilat janë bërë, janë vënë në  
10 dijeni palët dhe për këtë arsye dua që t'ju sjell në vëmendjen  
11 tuaj, që këto dy emra jepen në paragrafin 34 dhe 35 dhe në  
12 paragrafin 40.

13 Dhe në fund fare, sa i takon kësaj deklarate, ka një  
14 gabim në paragrafët, në numrin e paragrafëve. Numri 35, pra,  
15 nuk është numri i duhur në versionin në anglisht.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Si synoni që  
17 t'i përdorni këto emra? Do t'i caktoni një kod?

18 Z. BAARLINK: [Përkthim] Nuk besoj se do bëhen pyetje  
19 lidhur me këto dy emra.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po Mbrojtjet  
21 a janë të informuara sa i takon këtyre dy emrave?

22 Z. Emmerson.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kam një koment të përgjithshëm që  
24 dua ta sjell në vëmendjen tuaj. Ky koment është si më poshtë.  
25 Ky dëshmitar është parashtruar si dëshmitar fakti, jo si

1 dëshmitar si ekspert. Dhe si rezultat, deklaratat ose  
2 deklaratat e tij, janë një kombinim e informacioneve të  
3 mbledhura nga dëshmitarë që i dërgojnë, i tregojnë atij gjëra  
4 në terren, pra, gjatë kohës kur ai ka qenë në terren dhe sa i  
5 takon Mbrojtjes së Veselit, ne nuk kemi kundërshtim. Pra, sa i  
6 takon pyetjeve që kanë të bëjnë me themelin ose ku ka qenë  
7 dëshmitari ose çfarë i janë thënë atij.

8 Megjithatë, pavarësisht kësaj deklaratat fillestare  
9 përmbajnë opinione të dëshmitarit dhe me kalimin e kohës këto  
10 janë rritur në kuptimin që kemi edhe shënime të cilat  
11 përmbajnë një sasi të konsiderueshme opinionesh.

12 Kemi dy elementë këtu. Domethënë, edhe një dëshmitar  
13 ekspert nuk lejohet që të japë opinionet për çështje që duhet  
14 të merret vendim, për shembull, prania ose ekzistenca e një  
15 policie për të ndjekur bashkëpunëtorët ose persona të tjerë.

16 Megjithatë një gjë tjetër edhe më e rëndësishme sesa kaq,  
17 është që opinionet nuk duhet të nxirren nga dëshmitarë fakti  
18 dhe është marrë një vendim, janë marrë vendime të mëparshme  
19 lidhur me këtë gjë në TPNJ-në. Të nderuar Gjykatës, do t'ju  
20 jap referencën. Për shembull, Prokurori kundër Haradinajt,  
21 dokumenti është IT-04-84-TR-ET, që është bërë, gjithashtu edhe  
22 është dhënë një vendim me gojë më datë 6 mars 2007 dhe për  
23 transkript, ky është transkripti 457, rreshti 18 deri në 488,  
24 rreshti 22.

25 "Si rregull i përgjithshëm, opinionet nuk duhet të

1 nxirren ose nuk duhet të jepen nga dëshmitarët e faktit. Kur  
2 nuk është e qartë se cila është baza faktike e dëshmitarëve,  
3 palëve u kërkohet që të eksplorojnë më tej bazën e njohurive  
4 të dëshmitarit në varësi të asaj çfarë thotë ai”.

5 Ndërkohë që ka dhe një seksion më poshtë që thotë që këtë  
6 që unë sapo lexova më përpara.

7 Domethënë ajo çfarë dua të them është që nuk bëhet fjalë  
8 për një dëshmitar ekspert. Por kemi të bëjmë me një dëshmitar  
9 fakti. Kështu që si rezultat është i rëndësishëm që opinionet  
10 e tij të jenë sa më të kufizuara të jetë e mundur. Këto janë  
11 dy parime shumë të rëndësishme për mënyrën sesi do të bëhet  
12 marrja në pyetje e këtij dëshmitari.

13 Sigurisht, që në deklaratë ka shumë informacion dhe  
14 sigurisht, Gjykatësit do t’i japin peshë atyre pjesëve që janë  
15 me rëndësi. Megjithatë nuk ka justifikim që kjo provë apo  
16 pjesa e opinioneve e dëshmitarit në fjalë nuk duhet që të  
17 nxirret me anë të pyetjeve të Prokurorisë sepse kjo nuk është  
18 mënyra sesi duhet të bëhet kjo pjesë.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jam dakord me  
20 kundërshtimin e z. Emmerson, sikurse besoj që e keni lexuar  
21 dëshmia është plot me opinione të një personi që nuk është  
22 ekspert. Dhe opinionet jepen në shumë raste.

23 Mbase, të nderuar Gjykatës, duhet ta kishte nxjerrë në  
24 pah më herët këtë gjë. Jemi në një fazë të procesit gjyqësor  
25 ku shënimet e përgatitjes ose përgatitore nuk janë më shënime

1 përgatitore, por janë deklarata.

2 Domethënë, janë deklarata që janë me paragrafë. Për  
3 shembull, kemi këtë Shënimin Përgatitor që është numër 1. Dhe  
4 ka 13 faqe, i shkruar me shumë kujdes edhe me hapësirën  
5 ndërmjet rreshtave. Dhe e njëjta gjë është edhe e vërtetë dhe  
6 për Shënimin Përgatitor numër 2. Të nderuar Gjykatës, ne  
7 parashtrojmë se këto janë deklarata të reja. Deklarata të  
8 cilat ne i kemi marrë vetëm të shtunën dhe duke pasur parasysh  
9 kohën në dispozicion nuk kemi pasur kohë të mjaftueshme për të  
10 shqyrtuar atë.

11 Pra, po kalojmë në një fazë të re, në kuptimin që kemi  
12 deklarata për çdo dëshmitar të thërritur. Sikurse e tha dhe z.  
13 Emmerson, shpesh herë marrim opinione të cilat janë pjesë e  
14 shënimit përgatitor dëshmitarët dhe Prokuroria synon që t'i  
15 parashtrojë si pjesë e parashtimeve të rregullës 154 që më  
16 pas kërkojnë që të regjistrohen në prova materiale.

17 Thjesht dua t'ju them që këto janë dokumente, janë  
18 shënime përgatitore të cilat i kemi marrë vetëm të premtën.

19 Tani kemi një dokument të ri, kemi komente të reja, kemi  
20 prova të reja, të cilat janë tërësisht të pahetuara në këtë  
21 fazë. Kështu që besoj, të nderuar Gjykatës, se ne kemi të  
22 njëjtën qasje në kuptimin që nuk kemi marrë asnjëherë shënime  
23 përgatitore të cilat janë kaq shumë të hollësishme. Nuk janë  
24 thjesht shpjeguese, por përmbajnë shumë informacione të tjera.

25 z. Kryesues i seancës, besoj që ka seanca ose ka pjesë të

1 caktuara dëshmitari kur dëshmitari është shumë -- jep mendimin  
2 e vet, akuzat ose arsyet se pse mendon ai që një individ i  
3 caktuar i ka ndodhur diçka e caktuar. Kështu që në qoftë se  
4 jeni të interesuar sigurisht që mund t'ju a lexoj këto pjesë.  
5 Megjithatë, për pjesën më të madhe të kohës dëshmitari nuk ka  
6 qenë në Kosovë.

7 Megjithatë, e kuptoj të nderuar Gjykatës, që ne jemi të  
8 gjithë të interesuar që të ecë më përpara ky proces gjyqësor,  
9 nuk parashikoj që të shtyjmë marrjen në pyetje të këtij  
10 dëshmitari. Megjithatë, personalisht, jam i shqetësuar lidhur  
11 me atë çfarë është punë ose praktikë e pranueshme deri tani.  
12 Për atë që është bërë e pranueshme, në kuptimin që kolegët  
13 lejohen që - të shtojnë deklaratat e dëshmitarëve - dhe kemi  
14 këtu një dokument të ri të cilin, siç e thashë, e kemi marrë  
15 vetëm të shtunën në darkë, dokument i cili ka informacion të  
16 ri dhe, siç e tha edhe kolegu im, ekspert, domethënë,  
17 dëshmitari nuk është ekspert.

18 Kështu që dëshmitarit nuk duhet t'i jepet e drejta që t'i  
19 japi këtu opinionet e veta. Kështu që si rrjedhojë kërkoj që  
20 këto opinione të redaktohen nga shënimet përgatitore në mënyrë  
21 të tillë që shënimet përgatitore të mos behet provë në këtë  
22 proces gjyqësor. Kështu që do kërkoja që të vazhdojmë siç  
23 është planifikuar.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

25 Z. TULLY: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, në emër të

1 Mbrojtjes së Selimit, dëshiroj që t'i bashkohem parashtrimeve  
2 të kolegëve të mi, sa i takon përgatitjes së Njoftimit  
3 Përgatitor 2 që përgjithësisht është informacion i ri i  
4 dëshmitarit, megjithatë në qoftë se bëhet fjalë për  
5 informacion të ri duhet të jetë informacion fakti. Sepse  
6 dëshmitari është dëshmitar fakti. Nga ana tjetër në paragrafin  
7 10 të Shënimit Përgatitor 2, duket sikur jepet një *curriculum*  
8 *vitae* e personit në fjalë për të na bindur neve sepse personi  
9 është i kualifikuar për të dhënë opinionet që ai ka dhënë.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës edhe ne i  
11 bashkohemi shqetësimeve të ngritura nga kolegët. Në veçanti,  
12 për provat që do të nxirren, neve kundërshtojmë "Opinionet"  
13 ose provat në trajtën e opinionëve që synon Prokuroria që të  
14 nxjerrë nga dëshmitari në fjalë. Sigurisht që ne ju besojmë,  
15 të nderuar Gjykatës, si gjykatës profesionist që ju nuk do t'i  
16 merrni parasysh opinionet e dëshmitarit kur të shqyrtoni  
17 dokumentet dhe deklaratat e tij. Megjithatë për momentin për  
18 këtë seancë gjyqësore mendojmë që opinionet e dëshmitarit nuk  
19 duhet të nxirren përmes pyetjeve të Prokurorisë.

20 Z. BAARLINK: [Përkthim] Ky dëshmitar është dëshmitar  
21 fakti, jo si dëshmitar ekspert dhe për këtë arsye ne  
22 mbështetemi në dëshmitë që ai ka parë me sytë e veta, po  
23 gjithashtu edhe nga gjërat të cilat i ka dëgjuar nga të  
24 tjerët. Ne nuk do të mbështetemi në opinionet e tij.

25 Sa i takon shënimeve përgatitore dhe, më lejoni të them,

1 që nuk synoj që të nxjerr prova që mbështeten në opinionet e  
2 veta përmes marrjes në pyetje kryesisht nga Prokuroria.

3 Lidhur me shqetësimet e ngritura për shënimet  
4 përgatitore, parashtrimi im është se arsyeja që pse i jepet  
5 kaq rendësi këtyre shënimeve përgatitore, është që ne  
6 mundohemi që këto shënime të jenë sa më gjithëpërfshirëse të  
7 jetë e mundur. Ne përpiqemi që të identifikojmë mungesë  
8 konsistence paqartësi apo mangësi të tjera në mënyrë të tillë  
9 që të mund t'i trajtojmë ato në përputhje me urdhrin për  
10 ecurinë për procesit gjyqësor.

11 Dhe seksionet të cilat janë identifikuar nga mbrojtjet të  
12 cilat konkretisht trajtojnë apo kanë të bëjnë me opinionet e  
13 dëshmitarit në fjalë, ato rrjedhin ose vijnë si rezultat i  
14 pyetjeve që bëjmë neve lidhur me njohuritë që ai ka për gjëra  
15 të caktuara që i mbulon në deklaratë dhe ne nuk synojmë që  
16 mbulojmë të njëjtat tema edhe gjatë marrjes kryesisht në  
17 pyetje. Megjithatë ato janë në shënime.

18 Ju jeni gjykatës profesionistë dhe mund t'i jepni peshën  
19 e duhur apo të nevojshme të këtyre paragrafëve apo të këtyre  
20 pjesëve të shënimeve përgatitore dhe t'i anashkaloni tërësisht  
21 dhe të mos i jepni asnjë lloj vlere në qoftë se mendoni që ato  
22 nuk kanë peshë apo vlerë.

23 Sa i takon paragrafit 10 të shënimit të dytë përgatitor,  
24 ky është informacion që është dhënë vullnetarisht nga  
25 dëshmitari. E kemi përfshirë këtë informacion në mënyrë të

1 tillë që t'i japim njoftim të plotë Mbrojtjeve lidhur me atë  
2 çfarë na ka thënë dëshmitari gjatë marrjes në pyetje në mënyrë  
3 të tillë që të jemi plotësisht në përputhje me atë çfarë është  
4 vendosur prej jush, të nderuar Gjykatës, në urdhrin për  
5 zhvillimin e gjykimit. Dhe sa i takon sugjerimit që ne kemi  
6 shmangur ose nuk kemi respektuar procedurat e rregullta ose  
7 korrekte, unë mendoj që kjo është e pathemeltë.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Më lejoni një çast, ju lutem?

9 E kuptoj që ushtrimi ose shkrimi i shënimeve përgatitore  
10 nuk është një shkencë ekzakte. Megjithatë ajo çfarë bën  
11 Prokuroria është që përfshin opinionet e dëshmitarit që nuk  
12 është ekspert në shënimet përgatitore dhe dua që t'i  
13 parashtroj ato mbështetur në rregullin 154. Kështu që jam i  
14 sigurtë, të nderuar Gjykatës, ju garantoj, të nderuar  
15 Gjykatës, që ky opinion pastaj më pas do bëhet pjesë e çdo  
16 dosjeje parapërgatitore që do të japë Prokuroria.

17 Dhe mendoj që ky është problemi me mosmarrjen e një  
18 vendimi prej jush në këtë pikë, sepse në qoftë se nuk është  
19 pjesë e procesverbalit dhe, në qoftë se nuk hiqet atëherë kjo  
20 do bëhet problematike. Domethënë, nuk dua të marrë më tepër  
21 kohë, por dua që ta ngre këtë problem dhe mendoj që kjo është  
22 një çështje për të cilën ne të gjithën, pra, në ta gjitha  
23 ekipet e Mbrojtjes jemi të shqetësuara në këtë pikë të  
24 procesit gjyqësor.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kam



1 përshtypjen që e përdorëm të gjithë kohën, kështu që ka ardhur  
2 koha për pushimin e drekës. Nuk ka ardhur dreka akoma.

3 Më vjen keq. Ka ardhur koha për kafën e mëngjesit  
4 atëherë.

5 Në rregull. Do bëjmë pushimin dhe do kthehemi përsëri në  
6 orën 11.30.

7 --- Pauza fillon në orën 10.59

8 --- Seanca rifillon në orën 11.32 paradite

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se sa  
10 të sjellim dëshmitarin në sallën e gjyqit, do të jap një  
11 urdhër gojor. Shpresoja që të më vinte zëri, megjithatë më  
12 duhet që të lexoj një tjetër urdhër gojor të gjatë kështu që  
13 besoj që nuk do të kem mundësi që të rikuperoj zërin.

14 Trupi Gjykses do të marrë vendim lidhur me shqetësimin  
15 ose kundërshtimin e ngritur nga Mbrojtjet lidhur me provat e  
16 propozuara nga 02153.

17 Mbrojtja ngre tre ankesa. E para është që dëshmia është  
18 dëshmi opinionit e dëshmitarit në fjalë, dhe si rezultat kjo  
19 dëshmi nuk duhet që të pranohet.

20 Si çështje paraprake Trupi Gjykses vëren se: Rregullat se  
21 japin parime përjashtimore për dëshminë e opinionit për sa i  
22 takon dëshmitarëve të cilët nuk janë ekspertë. Gjithashtu,  
23 duhet të merren edhe faktorë të tjerë vendimtarë.

24 Nga ana tjetër Trupi Gjykses pranon propozimin e  
25 përgjithshëm të Mbrojtjes që dëshmi të tilla nuk duhet që të

1 çojnë në themelësi, të cilat çojnë në opinione të  
2 dëshmitarëve. Kështu që Trupi Gjykses pajtohet se shqetësimi i  
3 Mbrojtjes që opinionin e dëshmitarit nuk duhet të bjerë në  
4 fushën e veprimit të përgjegjësisë së Trupit Gjykses.

5 Kështu që Trupi Gjykses vëren më tej që opinionin e nuk  
6 duhet që të nxirret nga Prokuroria. Dhe është e rëndësishme që  
7 kjo dëshmi të mbështetet plotësisht në faktet dhe rrethanat të  
8 cilat mund të verifikohen. Në qoftë se do të ndodhë e kundërta  
9 dëshmia thjesht nuk do të merret parasysh ose do t'i jepet  
10 shumë pak peshë.

11 Trupi Gjykses si rezultat urdhëron ZPS-në që të redaktojë  
12 informacionin që përmbahet në shënimet e veta për përgatitjen  
13 e dëshmitarit, por gjithashtu i kujton ZPS-së që në qoftë se  
14 kërkon që të nxjerrë ose të mbështetet në prova të tilla nga  
15 dëshmitari, ato duhet të nxirren nga dëshmitari mbi bazën që  
16 dëshmitari ka formuar opinionin e vet.

17 Trupi Gjykses gjithashtu thekson që prova të tilla në  
18 parim nuk duhet të nxirren nga Prokurori i ZPS-së.

19 Ndërkohë që kundërshtimi i dytë ka të bëjë me natyrën  
20 dytësore të provës apo dëshmive të propozuara nga dëshmitari.  
21 Kjo është një çështje që vendoset nga Trupi Gjykses,  
22 megjithatë kjo mund të shtojë peshën ose të ndryshojë peshën  
23 që Trupi Gjykses mund t'i japë dëshmive të tilla.

24 Trupi Gjykses gjithashtu njofton palët që në këtë rast ne  
25 kemi nxjerrë dëshmi përmes dëshmitarëve në këtë mënyrë. Kështu

1 që si rezultat, Trupi Gjykses nuk lejon që këto pjesë,  
2 domethënë, të dëshmisë së dëshmitarit 0213 [sipas përkthimit]  
3 si dëshmi dytësore, megjithatë ne do t'i japim atë peshë të  
4 cilat meritojnë dëshmi të tilla.

5 Gjithsesi, Trupi Gjykses pajtohet me Mbrojtjen që këto  
6 dokumente po bëhen goxha të gjata, ato në fakt çojnë në disa  
7 raste në deklarata të reja.

8 Si rezultat, Trupi Gjykses thekson që parimi është që në  
9 shënimet përgatitore duhet që të reflektohen ato të cilat janë  
10 korigjime ose sqarime të deklaratave të mëparshme të dhëna  
11 nga dëshmitari. Kur jepen informacione shtesë, ose shpjegime  
12 të tjera ato duhet që të reflektohen në Njoftimin përgatitor 2  
13 të cilat ZPS-ja në diskrecionin e vet ose me vendosmërinë e  
14 vet, me të drejtën e vet, mund të kërkojnë që të pranohen *viva*  
15 *voce* këtu në sallën e gjyqit përmes dëshmitarit.

16 Ky është fundi i urdhrin gojor të Trupit Gjykses.

17 Znj. Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin në sallën e  
18 gjyqit.

19 Jemi në seancë publike.

20 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,  
22 Dëshmitar. A më dëgjon mirë?

23 DËSHMITARI: [Nuk ka përkthim]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretarja  
25 tani do t'ju japë tekstin e deklaratës solemne, ose ndoshta

1 ajo jua ka dhënë, se e shoh. Keni përpara deklaratën solemne  
2 të dëshmitarit që duhet ta lexoni në pajtim me rregullën  
3 141(2) të Rregullores.

4 Ju lutemi lexojini me zë.

5 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e  
6 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj  
7 solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe  
8 vetëm të vërtetën. Dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të  
9 cilën kam dijeni.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni, ju  
11 lutem.

12 DËSHMITARI: W02153

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do  
14 fillojmë me dëshminë tuaj sot. Sikurse e dini, Prokurori do  
15 t'ju bëjë pyetjet e para, Prokurori është i ulur këtu. Më pas  
16 ekipet e Mbrojtjes do t'ju bëjnë pyetjen, në fakt pas  
17 Prokurorisë do t'ju bëjë pyetje, në qoftë se ka, Mbrojtësi i  
18 Viktimave, dhe pastaj ekipet e Mbrojtjes.

19 Prokuroria ka planifikuar një orë për marrjen tuaj në  
20 pyetje. Mbrojtësi i Viktimave do të përdorë 20 minuta për  
21 pyetjet tuaja, ndërkohë që ekipet e Mbrojtjeve kanë vlerësuar  
22 se do të kenë nevojë për 15.5 orë. Sa i takon vlerësimeve  
23 shpresojmë që ekipet dhe palët të gjitha të -- mund të  
24 përdorin kohën e Gjykatës në mënyrë sa më efikase të jetë e  
25 mundur.

1 Dëshmitar, ju lutem mundohuni që të jepni përgjigjet  
2 shkurt, me fjali të shkurtra. Në qoftë se nuk e kuptoni  
3 pyetjen që ju drejtohet, kërkojini avokatit që nuk e kuptuat  
4 pyetjen ose ta bëjë ndryshe pyetjen dhe avokati do të mundohet  
5 që ta sqarojë pyetjen. Gjithashtu, ju lutem na thoni se cila  
6 është baza e njohurive tuaja, të fakteve dhe rrethanave për të  
7 cilat do t'ju bëhen pyetje.

8 Në rast se ZPS-ja ju kërkon që të vërtetoni disa  
9 korrigjime që janë bërë në deklaratat tuaja, juve ju kujtojmë  
10 që duhet të konfirmoni se korrigjimet e bëra reflektojnë  
11 korrigjimet që keni bërë dhe reflektojnë ndryshimet e duhura  
12 në deklaratat tuaja.

13 Ju lutem dëgjoni pyetjen deri në fund. Ju lutem bëni pesë  
14 sekonda pushim dhe pastaj jepni përgjigjen tuaj në mënyrë të  
15 tillë që t'ju kapin përkthyesit.

16 Gjatë ditëve që do të jepni dëshminë në këtë Gjykatë, nuk  
17 lejoheni që të diskutoni për dëshminë tuaj me askënd. Në qoftë  
18 se ndonjë person ju bën pyetje jashtë sallës së gjyqit sa i  
19 takon dëshmisë tuaj, ju lutem na e vini në dijeni këtë gjë.

20 Ju lutem ndaloni së foluri në qoftë se ju kërkoj që të  
21 ndaloni së foluri ose në qoftë se ngre dorën, kjo do të thotë  
22 që do të më duhet t'ju jap udhëzime të tjera.

23 Nëse keni nevojë të bëni pushime, lirisht na e thoni këtë  
24 gjë dhe do të plotësojmë kërkesën tuaj.

25 A jeni gati të fillojmë, Dëshmitar?

1 DËSHMITARI: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Prokuror  
3 mund të filloni tani.

4 Pyetje nga z. Baarlink:

5 Z. BAARLINK: [Përkthim]

6 PY. Mirëmëngjes, dëshmitar.

7 PË. Mirëmëngjes.

8 PY. Dëshmitar, si quheni?

9 PË. Francis Ledwidge.

10 PY. Kur dhe ku keni lindur?

11 PË. 23 tetor 1966, në Liverpul në Angli.

12 PY. Çfarë shtetësie keni?

13 PË. Shtetësi të dyfishtë, të Mbretërisë së Bashkuar dhe të  
14 Irlandës.

15 PY. Në rregull. Do t'ju bëj disa pyetje lidhur me tri  
16 deklarata të mëparshme që keni dhënë.

17 Z. BAARLINK: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem a mund  
18 të paraqisni në ekran dokumentin 114301 deri në 114316\_F01664.

19 Ju lutem mund të kalojmë në fund të kësaj faqeje.

20 PË. [Nuk ka përkthim]

21 PY. Dëshmitar, a e njihni këtë nënshkrim?

22 PË. Po. Është nënshkrimi im.

23 Z. BAARLINK: [Përkthim] Le të kalojmë tek faqja e fundit  
24 e këtij dokumenti që është faqja 114316.

25 PY. A e njihni këtë nënshkrim?

1 PË. Po, e njoh.

2 PY. Është nënshkrimi juaj?

3 PË. Po.

4 Z. BAARLINK: [Përkthim] Znj. Sekretare, a mund të  
5 paraqisni në ekran dokument tjetrin që është U008-7623 deri në  
6 U008-7629. Të shkojmë në faqen U008-7625. Në fund të kësaj  
7 faqeje.

8 PY. A e njihni nënshkrimin këtu, dëshmitar?

9 PË. Po.

10 PY. Është nënshkrimi juaj?

11 PË. Po, është nënshkrimi im.

12 Z. BAARLINK: [Përkthim] Të kalojmë në faqen U008-7628.

13 PY. Edhe ky është nënshkrimi juaj?

14 PË. Po, edhe ky është nënshkrimi im.

15 Z. BAARLINK: [Përkthim] Do të kërkoja që të paraqitet në  
16 ekran dokumenti i radhës që mban numrin 01068151 deri  
17 01068166. Të kalojmë në fund të faqes.

18 PY. A e njihni nënshkrimin tuaj këtu?

19 PË. Po.

20 Z. BAARLINK: [Përkthim] Të kalojmë në faqen e fundit të  
21 këtij dokumenti me numër identifikimi 01068166.

22 PY. E njihni nënshkrimin tuaj në këtë faqe?

23 PË. Po.

24 PY. Sapo ju tregova tri deklarata. A keni pasur kohë kohët e  
25 fundit që të rishikoni përmbajtjen e këtyre tri deklaratave?

1 PË. Po.

2 PY. Në seancën përgatitore javën që shkoi juve bëtë disa  
3 sqarime në këto deklaratata?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe këto sqarime u pasqyruan në një shënim i cili ju  
6 lexua juve?

7 PË. Po.

8 PY. A konfirmoni se ato që ju lexuan juve nga ky shënim  
9 reflektojnë siç duhet sqarimet që bëtë për deklaratat tuaja?

10 PË. Po.

11 PY. Dhe duke marrë parasysh dhe sqarimet që bëtë në atë  
12 shënim, informacioni që ju keni dhënë në deklaratat tuaja  
13 është i vërtetë dhe i saktë në dijeninë tuaj dhe në besimin  
14 tuaj më të mirë?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe duke marrë parasysh sqarimet e dhëna në shënim,  
17 deklaratat tuaja pasqyrojnë siç duhet atë çfarë keni thënë  
18 gjatë deklaratave për ZPS-në, dhe a do të ishte e njëjta gjë  
19 që do të thonit këtu para Trupit Gjykses sot?

20 PË. Po.

21 PY. Të nderuar Gjykatës, sipas rregullës 154, sipas kritereve  
22 të kësaj rregulle dhe në pajtim me parashtrimin e  
23 protokolluar, F001164, kërkoj pranimin e deklaratave të më  
24 përparshme. Janë deklaratat me numër ERN-je 114301 deri në  
25 114316\_F01664 dhe përkthimi në shqipe është 114301 deri në



1 114316-AT\_F001664.

2 Dokumenti i dytë është U008-7623 deri në U008-7629.

3 Përkthimi në shqipe është U008-7623 deri në U008-7629-AT.

4 Ndërkohë që deklarata e tretë është dokumenti 01068151  
5 deri në 01068166. Përkthimi në shqipe është 01068151 deri në  
6 01068166-AT.

7 Kërkoj që të pranohet gjithashtu edhe Shënimi përgatitor  
8 1 me numër ERN 114236 deri në 114248.

9 Dhe më tej kërkoj që të pranohen provat materiale  
10 shoqëruese ndaj deklaratave, të cilat janë të identifikuara në  
11 vendimin F001664. Dhe ERN-të përkatëse përcaktohen në kërkesën  
12 sipas Rregullës 154 të ZPS-së që është F01625 dhe Shtojca 7 e  
13 këtij dokumenti.

14 Të nderuar Gjykatës, në këtë pikë kërkoj që të lexohet  
15 përmbajtja e rregullës 154 për dëshmitarin.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë  
17 kundërshtim për pranimin e këtyre dokumenteve?

18 Z. KEHOE: [Mikrofoni çaktivizuar]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Përveç kundërshtimeve që ngrita më  
21 përpara, nuk kam të tjera.

22 Z. STRONG: [Përkthim] Nuk kam kundërshtime as unë.

23 Z. TULLY: [Përkthim] Nuk kam kundërshtime as unë, i  
24 nderuar Gjykatës.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumentet të

1 cilat u paraqitën nga Prokurori, pranohen në prova materiale.

2 Mund të vazhdoni z. Prokuror.

3 Prisni një sekondë, derisa Sekretarja të mund të caktojë  
4 numrin e provave materiale.

5 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do  
6 caktoj numrat e provave materiale. Do t'ju njoftoj më vonë  
7 lidhur me këtë.

8 Deklarata e parë që morëm, do të marrë numrin e provës  
9 materiale P230.

10 Deklarata e dytë do të marrë numrin e provës materiale  
11 P231.

12 Deklarata e tretë do të marrë numrin e provës materiale  
13 P232.

14 Dhe shënimi përgatitor do të marrë numrin e provës  
15 materiale P233.

16 Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

18 Z. BAARLINK: [Përkthim] Propozoj që të lexohet  
19 përmbledhja e deklaratës së dëshmitarit sipas rregullës 154.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

21 Z. BAARLINK: [Përkthim] Dëshmitari 2153 ka qenë oficer i  
22 ushtrisë britanik i cili ka shërbyer në KDOM-in e Mbretërisë  
23 së Bashkuar dhe Misionin e OSBE-së në Kosovë nga nëntori i  
24 vitit 1998 deri në mars 1999, dhe nga korriku 1999.

25 Dëshmitari ka hetuar rastet e personave të cilët janë

1 ndaluar nga UÇK-ja dhe të cilët janë zhdukur më ose rreth  
2 datës 17 korrik 1998 në Rahovec dhe në zonat përreth.

3 Ai ka kryer intervista me persona që kanë të bëjnë me  
4 këtë ngjarje, përfshirë këtu edhe të ndaluar të mëparshëm dhe  
5 anëtarë të familjeve të viktimave. Dy persona i kanë thënë  
6 dëshmitarit se me ta ka folur Jakup Krasniqi.

7 Dëshmitari është ndaluar shkurtimisht nga forcat serbe  
8 pas zhdukjes së vëllezërve më datë 27 shkurt 1999.

9 Dëshmitari gjithashtu ka hetuar të paktën rrëmbimin e  
10 pesë serbëve nga ushtarë të uniformuar dhe të armatosur të  
11 UÇK-së në Rahovec rreth datës 16 qershor 1999.

12 Më ose rreth nëntorit 1999, dëshmitar ka dëgjuar nga  
13 shumë persona që Hashim Thaçi ka dhënë një fjalim në një  
14 miting të organizuar në Rahovec në të cilin ka deklaruar kohën  
15 për -- kur flitej serbisht në Rahovec --  
16 PY. Dëshmitar, do t'ju bëj disa pyetje që kanë të bëjnë me  
17 zhdukjet në korrik të vitit 1999.

18 Z. BAARLINK: [Përkthim] Znj. Sekretare mund të paraqisni  
19 në ekran dokumentin SPOE40010571 deri në 40010579.

20 PY. Dëshmitar, e shikon këtë dokument? A e keni parë më  
21 përpara këtë dokument?

22 PË. Po.

23 PY. A mund t'i tregoni Trupit Gjykues se çfarë është ky  
24 dokument?

25 PË. Është një procesverbal i një interviste që unë kam

1 organizuar me ca ndihmë, apo asistencë, në Hoçë të Madhe ose  
2 në një qendër koordinimi në Rahovec, rreth datës 4 -- janar  
3 [sipas përkthimit] kam përshtypjen që është më 4 janar --  
4 besoj që këtë datë mban -- kjo është data që mban dokumenti, 4  
5 janar 1999.

6 PY. A e keni shkruar ju këtë dokument?

7 PË. Po. Më duhet të jem i saktë, është dokument i cili është  
8 shkruar me ndihmën e disa përkthyesve.

9 PY. Në çfarë gjuhe flisnin përkthyesit? Të çfarë gjuhe ishin  
10 përkthyesit?

11 PË. Të gjuhës serbe.

12 PY. Edhe sa staf tjetër ishte që ju kanë ndihmuar?

13 PË. Përveç meje kam përshtypjen që dy, mbase tre.

14 PY. A ju kujtohet se çfarë përfshirje kanë pasur ata për  
15 shkrimin e këtij dokumenti?

16 PË. Po, kanë qenë përkthyes dhe më kanë ndihmuar për shkrimin  
17 e këtij dokumenti.

18 PY. E cekët edhe më herët këtë, por dua t'ju pyes edhe një  
19 herë. A ju kujtohet se kur janë bërë këto intervista?

20 PË. Nuk më kujtohet saktësisht, por intervistat i kemi bërë  
21 herët, ndoshta në fillim të janarit, ndoshta natën e vitit të  
22 ri. I kemi bërë në Hoçë të Madhe. Dhe intervistat e tjera, kam  
23 përshtypje dy ose tre prej tyre, janë bërë në qendrën tonë  
24 koordinuese, ose si me thënë, në shtabin tonë në Rahovec.

25 PY. Në rregull.

1 PË. Nëse më lejoni, dua që të them diçka më tepër lidhur me  
2 këtë. Me sa më kujtohet mua, pjesa më e madhe e këtyre  
3 intervistave janë kryer në Hoçë të Madhe.

4 Z. BAARLINK: [Përkthim] Znj. Sekretare, a mund ta kaloni  
5 më poshtë në dokument?

6 PY. A e shikoni një datë në fund të këtij dokumenti, z.  
7 Dëshmitar? Ndoshta duhet të bëj këtë pyetje së pari: A e keni  
8 lexuar kohët e fundit këtë dokument?

9 PË. Po.

10 PY. A jeni njohur me përmbajtjen e këtij dokumenti?

11 PË. Po, mendoj se po.

12 PY. Ka disa data të cilat jepen në fund të secilës prej  
13 deklaratave.

14 PË. Po.

15 PY. A janë të sakta këto dokumente me sa ju kujtohet?

16 PË. Nuk kam arsye për të besuar se datat nuk janë të sakta.

17 PY. Informacioni në dokument, a pasqyron atë çfarë ju kanë  
18 thënë personat që keni intervistuar në atë kohë?

19 PË. Po, kështu është.

20 Z. BAARLINK: [Përkthim] Znj. Sekretare e seancës, ju  
21 lutem kaloni disa faqe më poshtë në dokument. Vazhdojmë më tej  
22 tek faqja tjetër. Një faqe më poshtë. Vazhdojmë një faqe  
23 tjetër më poshtë. Vazhdojmë edhe më poshtë. Vazhdojmë dhe një  
24 faqe më poshtë. Dhe mbërrijmë në faqen e fundit të këtij  
25 dokumenti.

1 DËSHMITARI: [Përkthim] Të bëj një sqarim, në qoftë se  
2 është e mundur. Mendoj që fshati [sipas përkthimit] Slavka  
3 është i redaktuar, dhe është bërë në Rahovec intervista. I  
4 afërmi i këtij personi është marrë nga Rahoveci.

5 Z. BAARLINK: [Përkthim] Në rregull.

6 PY. Sa i takon procesit të krijimit të këtij dokument, ju  
7 lutem ma shpjegoni pak. Domethënë ju jeni takuar me persona në  
8 Hoçë të Madhe në Rahovec, dhe keni folur me këta persona dhe i  
9 keni marrë në pyetje ata, i keni intervistuar, kështu?

10 PË. Po.

11 PY. A mund të na thoni se çfarë ka ndodhur nga intervistimi  
12 deri tek hartimi i këtij dokumenti, ose këtyre dokumenteve.

13 PË. Kanë kaluar 25 vite që prej asaj kohe, kështu që procesi  
14 përmes të cilit i kemi përkthyer shënimet në dokumentet e  
15 shkruara sa i takon personave të zhdukur, nuk më kujtohet  
16 ekzaktësisht. Megjithatë, nuk do isha -- i habitur që të  
17 diskutonim ndërmjet nesh apo t'ia lexonim mbrapsht këtë  
18 dokument dëshmitarit.

19 Po ashtu, ne nuk i kemi kërkuar që të nënshkruajë --  
20 fatkeqësisht -- këtyre dëshmitarëve këto dokumente sepse  
21 synimi kryesor i këtyre dokumenteve nuk ishte që të  
22 përdreshin ën sallë gjyqi. Kështu që për pasojë ishte  
23 informacion që është përdorur vetëm thjesht në shtabet tona,  
24 ose në zonat tona. Besoj që menjëherë pasi është bërë  
25 intervista, i kemi shtypur ato. Pasi ka kaluar një kohë e

1 shkurtër. Mbase i kemi shtypur në të njëjtën ditë. Megjithatë  
2 kam pasur një kopje elektronike të cilën ndoshta e kam  
3 vendosur ose nuk e di se ku e kam vënë.

4 PY. Ju thatë që këto informacione i keni pasur për pasojat  
5 tuaja, ose si me thënë, për qëllimet tuaja. Çfarë qëllimi ka  
6 qenë ky?

7 PË. Qëllimi i organizatës ka qenë të përpiqej që të  
8 përcaktonte fatin ose vendndodhjen e anëtarëve të familjeve të  
9 personave të cilët janë të përfshirë në këto deklaratat.

10 PY. Informacioni që kanë këto dokumente, mbështetet thjesht  
11 në intervistat që keni organizuar ju në datat që përmendëm më  
12 herët?

13 PË. Po. Besoj që është e drejtë të thuhet kjo.

14 Z. BAARLINK: [Përkthim] A mund të kalojmë në faqen  
15 SPOE40010575? Le të kalojmë në fund të kësaj faqeje.

16 PY. Është një emër këtu, Snegena Baljosevic. A e shihni këtë  
17 emër?

18 PË. Po, e shoh.

19 PY. Ju lutem më thonë, domethënë Snegena a shqiptohet  
20 ndryshe?

21 PË. Mendoj se po ta shkruaja sot do ta shkruaja ndryshe, do  
22 ta shkruaja Snezena. E njëjta gjë me fjalën tjetër, Bozanovic.

23 PY. Në faqen tjetër është data 28 dhjetor 1998. Një faqe më  
24 sipër ju lutem.

25 A ju kujtohet që keni folur me Snezena Baljosevic në këtë

1 datë, më 28 dhjetor 1998?

2 PË. Të nderuar Gjykatës, nuk jam i sigurt sepse 28 dhjetori  
3 nuk pasqyrohet në deklaratën që pamë më herët. Megjithatë më  
4 kujtohet se kam folur me Snezana në disa raste. Në fakt më  
5 kujtohet shumë mirë ajo.

6 PY. A është kjo hera e parë që keni folur me të?

7 PË. Jo, nuk është hera e parë që kam folur me të.

8 PY. Por, informacioni që keni hedhur këtu është informacion  
9 që mbështetet në intervistën më datën 28 dhjetor?

10 PË. Po. Vendorsëm që ta formalizonim, ta bënim zyrtar  
11 informacionin që na kishte dhënë dëshmitarja. Për të qenë i  
12 qartë, i nderuar Gjykatës, kemi mbërritur në Rahovec - do t'i  
13 them Rahovec vendit - në fund të nëntorit 1998. Ditën e parë,  
14 të afërmit e disa serbëve erdhën që të na vizitonin ne, që të  
15 takoheshin me ne. Erdhën për të na takuar thuajse përditë,  
16 kështu që ne i njihnim mirë të gjithë këta njerëz.

17 Kjo ishte hera e parë kur unë e mbaj mend që bëmë  
18 raportimin, ose bëmë si me thënë, zyrtarizimin ose shkrimin e  
19 raportimeve të tyre.

20 PY. A ju kujtohet konkretisht që të jeni takuar me Sladjana  
21 [sipas përkthimit] Baljosevic në atë ditë?

22 PË. Më kujtohet Sladjana [sipas përkthimit] që ishte ulur  
23 para meje, përballë meje. Nuk e mbaj mend që është ajo datë,  
24 por nuk kam ndonjë arsye për të besuar që ka qenë -- një ditë  
25 tjetër. Sladjana [sipas përkthimit] është njëra prej atyre



1 personave që ne e takuam shpesh, me të drejtë.

2 PY. E dini kohën në përgjithësi kur u bë ky takim?

3 PË. Sa i takon Snezanas, me sa më kujtohet, kjo ka qenë nga  
4 të parat vejusha që kanë ardhur na kanë parë, na kanë bërë  
5 vizitë. Bashkë me vjehrrën e saj, dhe pastaj disa të tjerë i  
6 kemi takuar disa të tjerë në këto deklaratat. Pyetja ka qenë  
7 për herë të parë mund të ketë qenë në fund të nëntorit 1998,  
8 më 25 apo rreth kësaj date.

9 PY. A ju kujtohet hera e fundit pak a shumë? Hera e fundit  
10 pak a shumë kur keni bisedu me të?

11 PË. Do të thoja nga marsi 1999.

12 PY. Në këtë periudhë kohore, si paraqitej ajo? Si dukej?

13 PË. Burri i Snezanas ishte rrëmbyer dhe nuk kishte disa muaj  
14 që ishte zhdukur. Kishte një fëmijë të vogël, beb. Edhe që  
15 ishte marrë edhe peng. Dhe me sa më kujtohet, ishte stresuar.  
16 Dhe me raste të caktuara ishte e dëshpëruar me punën e atyre  
17 që po merreshin me hetimin e zhdukjes së burrit të saj, që  
18 kuptohej. Pra përgjigja për sa i përket sjelljes së saj me sa  
19 më kujtohet ishte se ishte shumë e mërziur dhe në gjendje  
20 stresi të lartë.

21 Ne i kërkonim asaj që të rikujtonte të na tregonte  
22 ngjarje jashtëzakonisht stresuese dhe natyrisht që kjo nuk ka  
23 pasë ndikim të mirë tek ajo.

24 Z. BAARLINK: [Përkthim] Nëse shkojmë tek faqja

25 SPOE40010577.

1 PY. Në fillim të faqes thuhet:

2 "Deklarata e Slavka Baljovic [sipas përkthimit]..."

3 E shihni këtë?

4 PË. Po, e shoh.

5 PY. Emri i parë është Slavka, ka versione të ndryshme të  
6 këtij emri.

7 PË. Besoj që po. Megjithatë nuk jam ekspert në shkurtesat.

8 Emër sllav. Kemi pasë disa emra sllavë me të cilët jemi marrë.

9 Kjo ka qenë Skllavka [sipas përkthimit] edhe gjithmonë e kam  
10 njohur si Sllavka.

11 PY. Mund të ketë qenë Slavica [sipas përkthimit]?

12 PË. Mund të ketë qenë.

13 Z. BAARLINK: [Përkthim] Mund të kalojmë tek faqja  
14 vijuese. Në fund të faqes.

15 PY. E shihni datën aty, 9 janar 1999?

16 PË. Po.

17 PY. A të kujtohet që ke bisedu me Slavka Bajolevic [sipas  
18 përkthimit] më këtë datë 9 janar?

19 PË. Nuk jam i sigurt që të konfirmoj këtë që më kujtohet, kjo  
20 në veçanti, ky rast, sepse kam takuar Slavkan shpesh. Disa  
21 herë e kemi takuar në shtëpi, ku i kemi bërë vizitë për t'i  
22 dhënë informacione të reja që kishim. Ajo ka ardhë të na shohë  
23 edhe ajo neve. E kam parë atë përpara se të jepnim  
24 intervistën? Nuk jam i sigurt që më kujtohet. Nuk jam i sigurt  
25 për këtë që të më kujtohet saktësisht.

1 PY. Për sa i përket periudhës kohore jeni marrë me këtë rreth  
2 të njëjtës periudhë kohore nga dhjetori deri në mars?

3 PË. Po.

4 PY. Dhe gjatë kësaj kohe, si paraqitej ajo, si dukej?

5 PË. Slavka dhe kjo -- kishte përjetuar trauma ekstreme, të  
6 jashtëzakonshme. Do të thotë që sjellja e saj ishte pak më e  
7 drejtpërdrejtë, emocionet shiheshin, shfaqeshin, më pak. Por e  
8 rrënjosur në traumë edhe ajo. Dhe këtu, më kujtohet, për sa i  
9 përket Slavkas që në mënyrë të kuptueshme kishte humbur  
10 besimin në atë që ne mund të bënim, apo për sa i përket  
11 misionit tonë. Kjo ishte diçka e zakonshme dhe për të tjerë.

12 Z. BAARLINK: [Përkthim] Nëse mund të kalojmë tek faqja  
13 SPOE40010578.

14 PY. Shihet deklarata e Jovan Lukic këtu.

15 PË. Po.

16 PY. Kalojmë tek faqja vijuese ju lutem. Edhe këtu data është  
17 9 janar 1999.

18 A ju kujtohet diçka që keni biseduar me këtë datë 9 janar  
19 1999 me Jovan Lukic?

20 PË. Po, më kujtohet.

21 PY. Si dukej ai?

22 PË. Siç e thashë në hyrje, edhe ai ishte jashtëzakonisht i  
23 mërziur. Nuk donte të fliste për ngjarjen që kishte ndodhur  
24 dhe na e tha këtë. Kjo ishte se si -- është ajo që kemi  
25 zbuluar, që kemi arritur të nxjerrim nga ai.

1 Që të jemi të drejtë, më kujtohet që kam biseduar me të  
2 në shtëpinë e tij. Ndoshta e kemi bo atë ditë, apo i kemi  
3 kërkuar atij që të vijë tek zyra, selia, jonë. Por me sa më  
4 kujtohet, deklaratën e tij e kemi marrë në shtëpinë e tij.  
5 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Këto ishin pyetjet që kisha  
6 lidhur me këtë dokument.

7 Z. BAARLINK: [Përkthim] Z. Gjyqtar do të doja të dorëzoja  
8 si provë dokumentin SPOE041 [sipas përkthimit] dhe versionin  
9 në shqip me ERN -A [Sipas përkthimit].

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim përveç  
11 kundërshtimeve që kishim më parë.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Kundërshtimi jonë është këto janë  
13 thjesht deklarata, deklarata që kanë të bëjnë me deklaratat i  
14 keni vendosur lidhur me këto, në bazë të rregullës 153, 143,  
15 144 dhe 145 [sipas përkthimit]. Dhe rastet kur Mbrojtja ka  
16 kërkuar që të dorëzojë deklarata të tjera gjatë marrjes në  
17 pyetje. Duke plotësuar këto rregulla, dhe këto thjesht nuk  
18 plotësojnë kushtet që të -- nga rregulla 155.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të  
20 vendosim më vonë lidhur me këtë.

21 Z. BAARLINK: [Përkthim] Në qoftë se mund të përgjigjem  
22 ndaj këtij kundërshtimi.

23 Në parashtrimin tonë, por ky parashtrim është kundër  
24 vendimit tuaj të mëparshëm në një vendim në rastin Gucati dhe  
25 Haradinaj, ku ju keni interpretuar kuptimin e fjalës deklaratë

1 nga rregulla 153 dhe 155. Dhe në veçanti ju kujtoj paragrafin  
2 85, 87, të vendimit në rastin Gucati dhe Haradinaj. Vendimi  
3 F00334, dhe veçanërisht paragrafi 86 ku ju z. Gjyqtar keni  
4 deklaruar se megjithatë Trupi Gjykues njeh se:

5 "Deklaratat me shkrim nga rregulla 153-154 [sipas  
6 përkthimit] duhet të merren në kontekstin e, apo lidhur me,  
7 procedurat ligjore që janë brenda fushëveprimit të këtyre  
8 veprimeve, për t'i dalluar ato nga deklaratat që nuk janë të  
9 lidhura me këto procedura. Në veçanti, Trupi Gjykues konstaton  
10 se faktori kyç në këtë vendim është nëse këto deklarata i janë  
11 dhënë një personi ose entiteti, i autorizuar për të mbledhë  
12 prova për përdorim në këto procedura gjyqësore".

13 Në këto paragrafë, paragrafi 85 dhe 87, citohet urdhri  
14 për menaxhimin e procedurës në paragrafin 74 shënimi 14, ku  
15 përcaktohet se fjala "deklaratë" duhet të kuptohet në  
16 përputhje me vendimin dhe vendimin gojor në Gucati dhe  
17 Haradinaj.

18 Pra parashtrimi im është që parim relevant këtu është që  
19 rregullat 153 dhe 155, në bazë të këtyre rregullave, deklarata  
20 me shkrim që të futet në fushëveprimin e këtyre rregullave  
21 duhet të merret në kontekstin apo në lidhje me procedurat  
22 gjyqësore. Dhe, dëshmitari sot deklaroi se arsyeja për të  
23 cilën ka marrë këto informata ishte për të gjetur personat e  
24 zhdukur dhe jo në kontekstin e procedurave gjyqësore.

25 Dhe kjo është në përputhje, z. Gjykatës, me vendimet e

1 mëparshme në këtë lëndë, F01380, paragrafi 50, dhe F01380  
2 [sipas përkthimit] paragrafi 158. Kanë të bëjnë me dokumente  
3 të ngjashme dhe kundërshtimet në këtë raste janë hedhur poshtë  
4 dhe dokumenti është pranuar nga ju, z. Gjykatës.

5 Pra, në parashtrimin tonë, nuk ka asgjë që ndalon  
6 pranimin e këtij dokumenti, në bazë të rregullës 138(1) dhe  
7 natyrisht për shkak të kësaj kjo nuk përbën një deklaratë në  
8 kuptimin e rregullës 153-155.

9 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

10 Z. STRONG: [Përkthim] Përpara që të vendosni nëse më  
11 lejoni të flas për një çështje, përpara që të merrni këtë  
12 vendim.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]  
14 Kërkoj ndjesë.

15 Z. STRONG: [Përkthim] Isha pak i ngadaltë.

16 Thjesht desha të them që ka disa sugjerime nga deklarata  
17 e këtij dëshmitari në bazë të rregullës 154 - 0105858 [sipas  
18 përkthimit] në faqen 12, ai është autorizuar që të mbledhë  
19 informacione dhe t'i kalojë në Hagë. Dhe e ka marrë këtë  
20 autorizim për të bërë një gjë të tillë. Pra, në qoftë se  
21 lexojmë paragrafin:

22 "Gjatë dy bisedave me këtë person", Koloneli Milan  
23 Petrovic, "Më pyeti nëse kam autoritet që të transferoj  
24 informacione në Hagë. Unë përpara këtij takimi kam marrë  
25 autorizim për të bërë këtë gjë. I thashë kolonelit këtë."

1 Të paktën disa prej informacioneve të mbledhura janë  
2 mbledhur për këtë qëllim, për të çuar më tej hetimin, ose një  
3 hetim. Faleminderit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të marrim  
5 një vendim lidhur me këtë pas pushimit të drekës.

6 DËSHMITARI: [Përkthim] Nëse më lejoni?

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po?

8 DËSHMITARI: [Përkthim] Z. Gjykatës, Do të flas për sa i  
9 përket çështjes së Hagës.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

11 DËSHMITARI: [Përkthim] Nëse më lejohet të jap disa  
12 sqarime për çështjen që sapo u ngrit për sa ai përket  
13 përdorimit të deklaratave në Hagë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Kuptoj.

16 Z. BAARLINK: [Përkthim]

17 PY. Dëshmitar, kam edhe një dokument tjetër që dëshiroj ta  
18 tregoj. Në qoftë se mund të na shfaqni në ekran dokumentin  
19 SPOE00198367 deri 00198834. Nëse mund të kalojmë tek faqja  
20 SPOE00198585 -- kërkoj ndjesë SPOE00198573.

21 PY. Në rregull. A e shihni këtë dokument në ekran?

22 PË. E shoh.

23 PY. E njeh këtë raport?

24 PË. E njoh.

25 PY. A nuk t'i thoni -- se çfarë është ky, Trupit Gjykses?

1 PË. Po, ky është një pjesë nga raporti i hetimit të OSBE-së  
2 për sa i përket -- për të drejtat e njeriut. Në këtë rast  
3 është përpara ndërhyrjes së NATO-s. Që ka të bëjë me shkeljet  
4 për të drejtat ndërkombëtare të njeriut pas ndërhyrjes.

5 Z. BAARLINK: [Përkthim] Për pyetjen nëse mund të kalojmë  
6 tek faqja SPOE00198585. Dhe pastaj tek SPOE0019593.

7 PY. Kjo numër, SPOE00198573 deri në SPOE0019593, siç e thatë  
8 më parë kjo është një pjesë -- që na e keni dhënë kohët e  
9 fundit?

10 PË. Po.

11 PY. E keni shikuar këtë?

12 PË. Po.

13 PY. Dhe siç e thatë është një pjesë nga një raport më i  
14 gjerë. Për çfarë bëhej fjalë në këtë pjesë në veçanti?

15 PË. Nuk e kam për momentin në ekran.

16 Z. BAARLINK: [Përkthim] Kemi faqen.

17 PY. Po pyes në përgjithësi për çfarë bëhet fjalë për  
18 vendndodhjen.

19 PË. Shkelje e të drejtave të njeriut në zonën e Rahovecit.

20 PY. Faleminderit. Keni kontribuar personalisht në këtë pjesë  
21 të raportit?

22 PË. Besoj që po.

23 PY. Në çfarë mënyre?

24 PË. Procedura ka qenë -- kjo ishte pas bombardimit të NATO-s,  
25 që është në fund të 1999. Na është kërkuar që të marrim pjesë,



1 të kontribuojmë në këtë, apo të editojmë në këtë raport.  
2 Editori për zonën e Prizrenit. I kemi dorëzuar kolegëve tanë  
3 në Prishtinë, redaktorëve në Prishtinë, që ishin shumë të aftë  
4 për të bërë këtë gjë.

5 PY. [Nuk ka përkthim]

6 PË. Siç më kujtohet, ishte rreth deklaratave që OSBE-ja  
7 kishte marrë apo pranuar.

8 PY. Në rregull. Duke qenë se i keni lexuar këto faqe së  
9 fundi, a mund të thoni që informacionet që janë aty janë  
10 përgjithësisht në përputhje me mënyrën se si i keni kuptuar ju  
11 ngjarjet në Rahovec në këtë periudhë kohore?

12 PË. Po, në përgjithësi janë në përputhje.

13 Z. BAARLINK: [Përkthim] Z. Gjyqtar, kërkoj të dorëzoj si  
14 provë SPOE00198573 deri në SPOE00198593.

15 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës  
16 këshillohen]

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, z. Gjykatës.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi një  
19 problem me transkriptin aktualisht.

20 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës  
21 këshillohen]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Na duhen  
23 dhjetë minuta për të ndezur përsëri sistemin e transkriptit.  
24 Do të bëjmë pushim dhjetë minuta. Faleminderit.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 --- Pauza fillon në orën 12.21

2 --- Seanca rifillon në orën 12.33

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Dua një qartësim në lidhje me provën  
5 materiale që është në ekran. Prokurori mund ta vërtetojë në  
6 qoftë se është kjo pjesë e raportit "Ashtu siç është parë,  
7 ashtu është treguar".

8 Z. BAARLINK: [Përkthim] Po, është faqe e atij raporti.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, këtë sqarim e kërkoja.

10 Z. BAARLINK: [Përkthim] Është Vëllimi 1 i atij raporti.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A do të  
12 kërkon pranimin e kësaj faqe si provë materiale?

13 Z. BAARLINK: [Përkthim] Po.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
15 kundërshtime?

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] T'i japim një  
18 numër prove këtij dokumenti.

19 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] A mund të konfirmoj që  
20 bëhet fjalë për ekstraktin apo fragmentin që -- numrin të na e  
21 jepni, pra ERN për këtë faqe?

22 Z. BAARLINK: [Përkthim] Është faqja SPOE00198573 deri në  
23 00198593.

24 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e  
25 provës P234.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni ju nga  
2 Mbrojtja e z. Krasniqi ndonjë pyetje?

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po. Kërkoj që vendimin në lidhje  
4 me një provë materiale ta marrim pas përfundimit të dëshmisë  
5 së këtij dëshmitari. Në mënyrë që t'i shmangemi çdo ndikimi  
6 paragjykues që mund të ketë.

7 Z. ELLIS: [Përkthim] E kam fjalën për atë grup  
8 dokumentesh që kanë të bëjnë me prova verifikuese.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta  
10 trajtojmë këtë më vonë. A e pranuar dokumentin, atë faqen e  
11 raportit si provë materiale? Na e dhatë numrin znj. Sekretare?

12 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Nuk u kemi dhënë numër  
13 prove grupit të deklaratave që u përmendën më herët, por mund  
14 të marrin numrin P235.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim]

16 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] A duhet ta shënojmë për  
17 identifikim këtë grup deklaratah?

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]  
19 Nuk ju dëgjova me vëmendje.

20 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Sa për procesverbalin,  
21 të nderuar Gjykatës, SPOE40010571 deri në SPOE40010579 do të  
22 marrin numrin e provës P235, i shënuar për identifikim.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]  
24 Faleminderit. Mund të vazhdoni z. Prokuror.

25 Z. BAARLINK: [Përkthim] Derisa të vijë dëshmitari në

1   sallë, dua të korrigjoj një numër të ERN-së që kam dhënë më  
2   përpara. Numri i saktë i ERN-së është 114260 deri në 114272.  
3   Kërkoj ndjesë për gabimin.

4                               [Dëshmitari vijon dëshminë]

5           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të  
6   vazhdojë Prokurori.

7           Z. BAARLINK: [Përkthim] Nuk kam më pyetje për këtë  
8   dëshmitar.

9           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

10          Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kemi as ne pyetje për këtë  
11   dëshmitar.

12          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe keni  
13   ju fjalën.

14          Z. KEHOE: [Përkthim] Më duhen disa minuta që të  
15   përgatitem për pyetjet.

16          Jam gati për të fillu me pyetjet.

17          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Pa përkthim]

18                               Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe:

19          Z. KEHOE: [Përkthim]

20   PY.   Mirëdita z. Ledwidge. Unë jam Z. Gregory Kehoe dhe  
21   përfaqësoj Presidentin Hashim Thaçi në këtë çështje gjyqësore.

22          Dua që të diskutojmë pak të kaluarën tuaj, përpara se të  
23   caktoheshit në misionet e jashtme, ju keni qenë i përfshirë në  
24   fushën e inteligjencës për ushtrinë britanike.

25   PË.   Po.

1 PY. A mund të na thoni saktësisht aq sa mundeni, në qoftë se  
2 informacioni nuk është i klasifikuar, se kur filluat të bënit  
3 punë inteligjence në kuadër të ushtrisë britanike?

4 PË. Kam shërbyer dy mandate në Bosnjë. Njëri në dhjetor 1996,  
5 dhe ka përfunduar në maj 1997. Kam bërë edhe një shërbim  
6 tjetër, mandat tjetër, që ka qenë prej marsit deri në shtator  
7 1998. Në këtë të dytin kam shërbyer në cilësinë e  
8 përfaqësuesit të NATO-s, në një njësi të përbashkët që ishte  
9 fillimisht e njohur si IFOR dhe më vonë si SFOR.

10 PY. Ju si oficer i inteligjencës jeni dërgu në terren për të  
11 mbledhë informacion për eprorët e juaj?

12 PË. Gjatë atyre dy misionëve, dhe kjo është e saktë.

13 PY. Dhe është me rëndësi që gjatë mbledhjes së këtyre  
14 informacionëve ka qenë me rëndësi që ai informacion të  
15 identifikohet në mënyrë që të dihet specifikisht informacioni  
16 i mbledhur.

17 PË. Po, simbas kërkesave.

18 PY. Po. Padyshim që ashtu është. Në qoftë se informacioni  
19 lidhet me çështjen përkatëse. Dhe gjatë këtyre dy shërbimeve  
20 që keni bërë e keni mësuar serbishten.

21 PË. Ishte gjuha boshnjake, por mund të thuhet se po.

22 PY. Dhe atëherë kur e keni mësuar serbishten? Në tribunal  
23 quhet B/S/C, që është gjuha boshnjake/serbe/kroate, në  
24 renditjen alfabetike. Kur e mësuat këtë gjuhë?

25 PË. Duhet të kisha thënë aty nga mesi i 1996, mu para

1 dislokimit tim atje.

2 PY. Dhe para dislokimit tuaj atje, dhe këtë e keni thënë në  
3 deklaratat tuaja, më pas u dislokuat në Kosovë, në vitin 1998?

4 PË. Po, në fund të nëntorit.

5 PY. Dhe aty u dislokuat sepse -- si oficer i inteligjencës  
6 sepse e dinit serbishten.

7 PË. [Nuk ka përkthim]

8 PY. Dhe më korrigjoni nëse e kam gabim.

9 PË. Unë isha i dislokuar si verifikues dhe isha në cilësinë e  
10 një punonjësi civil gjatë kohës që shërbeva aty.

11 PY. Dhe këto ishin arsyet domethënë pse ju dislokuan aty  
12 sepse e dinit gjuhën serbe?

13 PË. Unë kisha përvojë në rajon dhe kisha njëfarë njohurie të  
14 gjuhës, mirëpo pjesa më e madhe e ekipeve tona përbëheshin nga  
15 njerëz si nga fusha ushtarake ashtu edhe ajo civile.

16 PY. Dhe, kur shkuat atje u vendosët fillimisht në Rahovec. A  
17 është kjo e saktë?

18 PË. Mendoj që qëndruam tre ditë në Beograd, dhe pastaj shkuam  
19 në Kosovë disa ditë kishim briefingje, raportime, duhesh të  
20 presim për udhëtimin, për transportin. Pika ku qëndruam me  
21 radhë ishte Prizreni, dhe pastaj u dislokuam në Rahovec në  
22 fund të nëntorit 1998.

23 PY. Dhe kur u dislokuat në fund të nëntorit në Rahovec, ju  
24 selinë tuaj e vendosët diku në majë të një kodre. A është kjo  
25 e saktë?

1 PË. Morëm me qira shtëpinë e një personi i cili jetonte në  
2 fund të rrugës kryesore të Rahovecit, diku në kodër. Ishte një  
3 shtëpi e vogël me një kopsht të vogël. Ishte e sigurt me aq sa  
4 mund të shihnim ne dhe ashtu vendosëm që të vendoseshim aty në  
5 atë kohë.

6 PY. Dhe kur ishte kjo? Kur u vendosët në këtë shtëpi?

7 PË. Diku nga fundi i 1998, nëntorit 1998. Ndoshta 26 nëntori  
8 apo rreth kësaj date.

9 PËRKTHYESI: Përkthyesit kërkojnë që folësi të bëjë një  
10 pauzë të shkurtër mes pyetjeve dhe përgjigjeve për hir të  
11 përkthimit.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. Dhe i kërkoj edhe  
13 dëshmitarit që ta marrë parasysh kërkesën e përkthyesve.

14 PY. Dëshmitar, domethënë, ju u vendosët në këtë shtëpinë në  
15 Rahovec së bashku me një zotëri tjetër.

16 PË. Jo, të nderuar Gjykatës, ne u dislokuam një ekip prej  
17 katër vetash dhe më pas na u bashkuan edhe persona të tjerë  
18 këtij grupi të vogël. I gjithë grupi përbëhej prej 22  
19 personave. Kurse të tjerët në atë kohë nuk kishim punonjëse  
20 gra në atë kohë, sepse ishin të shpërndara nëpër qytet dhe më  
21 pas u dislokuam nëpër këto baza në terren si t'i quash.

22 PY. Ky vendi ku u vendosët, ishte një pjesën e banuar me  
23 serbë në Rahovec?

24 PË. Po. Kjo është e saktë, siç kam thënë në deklaratën time,  
25 kam qenë para shumë kohësh atje, mirëpo e di që ishin dy pjesë

1 të qytetit, pjesa në kodër ishte banuar prej serbëve, kurse  
2 pjesa më e madhe, shumica e banorëve jetonin në pjesën e  
3 qytetit, rreth 90 për qind.

4 PY. Dhe ju vendosët që të vendoseshit në pjesën e banuar me  
5 serbë?

6 PË. Po.

7 PY. Dhe personi, sipas hierarkisë së OSBE-së, të cilës i  
8 raportoni, i referoni, ishte Susanne Pedersen. A është kjo e  
9 saktë?

10 PË. Linja e raportimit ishte mjaft jozyrtare në atë kohë.

11 Ishim një grup i shpërndarë në gjithë Kosovën, OSBE-ja në atë  
12 kohë unë i raportoja shefit tim që ishte Ian McLeod, më pas  
13 George Bordet [fonetikiisht]. Dhe teknikisht më pas gjatë kohës  
14 së konfliktit, Susanne.

15 PY. Unë nuk e kam ndërmjet t'ju kundërshtoj, thjesht po lexoj  
16 shënimet përgatitore që kanë paraqitë Prokurori si provë.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Është në paragrafin 10 kjo që e  
18 diskutoj me ju dhe mund ta shikoni.

19 PY. Kur u pyetët se kujt i raportoni juve thoni që  
20 fillimisht i keni:

21 "...raportuar Ian McLeod. Më pas Michel Maisonneuve, dhe  
22 kryesisht Zyrës për të Drejtat e Njeriut në Prishtinë, Susanne  
23 Pedersen".

24 Dhe a është kjo e saktë?

25 PË. Po. Por kur jeton me ekipin -- ti bisedon me anëtarët e



1 ekipit dhe të gjitha aranzhimet për nga aspekti operativ i bën  
2 në formë jozyrtare.”

3 PY. Përpara se të shkonit në Rahovec, thatë që morët pjesë në  
4 një brifing, raportim, kaluat disa ditë me persona të tjerë  
5 dhe më korrigjoni në qoftë se e kam gabim. Kishte dhe një  
6 periudhë kur njerëzit ju kanë dhënë një farë ide si të thuash  
7 për atë që çfarë kishte ndodhur në Rahovec disa muaj përpara  
8 vendosjes suaj aty, apo jo?

9 PË. Mund të thuhet se kishim shumë qartësi të vogël në lidhje  
10 me atë që se çfarë po ndodhte. Më kujtohet që kemi marrë pjesë  
11 në një raportim, brifing, lidhur me situatën në Rahovec, në  
12 Beograd me sa më kujtohet. Në Prishtinë më pas u takuam me  
13 përfaqësues të misionit diplomatik që na dhanë njëfarë  
14 raportimi të përgjithshëm për atë që po ndodhte në terren.

15 Pastaj kur shkuam në Prizren, ishim në mes të një  
16 konflikti që po zhvillohej në atë kohë, gjatë të cilit për çdo  
17 ditë vriteshin njerëz. Nuk respektohej armëpushimi dhe kështu  
18 me radhë. Dhe nuk kishim shumë edhe hapësirë që të merremi me  
19 çështje se çfarë kishte ndodhë përpara, por thjesht me ato që  
20 ishin aktuale për atë moment që ndodheshim aty.

21 PY. Gjatë kohës që mësuat për shqiptarët kosovarë që jetonin  
22 në Rahovec edhe për UÇK-në, me siguri që mësuat që UÇK-ja  
23 ishte faktikisht një strukturë rurale horizontale ushtarake,  
24 apo jo?

25 PË. Të jem i sigurtë, kjo pjesa për UÇK-në nuk ishte

1 përgjegjësia ime. Nuk më është raportu sikurse që thoni ju apo  
2 ndryshe.

3 PY. Tani, do të shikojmë një fragment nga ky raport i OSBE-  
4 së, "Siç është parë, ashtu është treguar".

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Është faqja me numrin SPOE00198098  
6 deri në 0198366. Është konkretisht faqja 151.

7 PY. Ju thatë se u përfshitë në përpilimin e Vëllimit 1 të  
8 këtij raporti.

9 PË. Jo, të të dy vëllimeve.

10 PY. Kështu thuhet në atë faqe:

11 "Struktura rurale e shqiptarëve të Kosovës ka mbetur  
12 relativisht horizontale, me besnikërinë ndaj familjes dhe  
13 fshatrave dhe më pak autoritet qendror. UÇK-ja zhvillohet si  
14 të thuash me një strukturë të lokalizuar me një komandë  
15 qendrore që është krijuar apo imponuar më pas."

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Tani do t'ju lexoj dhe një fragment  
17 nga ky raport që është në faqen SPOE00198152.

18 PY. "Përgjithësisht, deri në ardhjen e Agim Çekut në prill  
19 1999, me përvojën e tij ushtarake nga lufta në Kroaci, nuk  
20 kishte anëtarë apo personel të mirë-stërvitur, të trajnuar, të  
21 UÇK-së që mund të jepte udhëheqësi. Kishte vetëm disa ide  
22 shumë bazike në lidhje me taktikën e këmbësorisë."

23 A pajtoheni me këtë që është thënë në këtë libër të OSBE-  
24 së, në këtë raport të OSBE-së, pra "Ashtu siç është parë,  
25 ashtu është treguar".

1 PË. Unë nuk mund as të pajtohem as t'ju kundërshtoj sepse nuk  
2 kam qenë një analist ushtarak, a mund t'ju komentoj në lidhje  
3 me atë që thatë?

4 PY. Po.

5 PË. Në rastet e gjithave forcave kryengritëse, si për  
6 shembull në rastin e Talibanit, kështu faktikisht këto forca  
7 lindin dhe zhvillohen.

8 PY. Tani, kur shkuat ju në nëntor 1998, nëpërmjet hetimeve që  
9 keni kryer rreth ngjarjeve që kanë ndodhë në verën e 1998, unë  
10 do të përqendrohem në faktin që ju shkoni aty në nëntor të  
11 1998, mirëpo ato që keni hetuar ju janë ngjarje që kanë ndodhë  
12 në verën e 1998, apo jo?

13 PË. 80 deri 90 për qind të punës time kishte të bëjë me  
14 krimet e forcave serbe që po ndodhnin në atë kohë. Për sa i  
15 përket këtij hetimit konkret që po diskutojmë këtu, po do të  
16 thoja që keni të drejtë që po bënim hetime rreth ngjarjeve të  
17 verës të atij viti.

18 PY. Tani, po të shikojmë mbrapsht verën e 1998, dhe asaj që  
19 ndodhte në atë kohë, pas konsultimeve dhe këshillimeve me  
20 udhëheqës të ndryshëm, a nuk ishte një prej detyrave të juaja  
21 që të kuptonit, të mësonit se çfarë ndodhi në verën 1998, duke  
22 përfshirë se çfarë i ndodhi UÇK-së dhe çfarë i ndodhi forcave  
23 serbe?

24 PË. Puna ime, ishte që të përcaktoja fatin, domethënë se  
25 çfarë kishte ndodhur me personat e zhdukur.

1 PY. Ju u përpoqët që të flisnim me njerëzit dhe të kuptonit  
2 se cilat ishin strukturat ushtarake që vepronin në Rahovec,  
3 apo jo?

4 PË. Jo, kjo nuk ka qenë fushëveprimi im.

5 PY. Por e njihni Shaun Byrnes?

6 PË. Ndoshta e kam njoftur, mirëpo nuk më kujtohet.

7 PY. Ai ishte anëtar i KDOM-it dhe pastaj kaloi në Misionin  
8 Verifikues të Kosovës.

9 "Në qershor 1998, kur Holbrooke dhe Hill së pari  
10 kontaktuan me UÇK-në, përshtypja e Byrnes ishte se UÇK-ja nuk  
11 ishte e organizuar në mënyrë kohezive. Këto mendime i kishte  
12 bazuar në dijeninë e tij që kishte marrë prej komandantëve  
13 vendorë apo të zonave. Pas incidentit në shtëpinë Jashari të  
14 1998" --

15 Dhe ju jeni në dijeni të këtij incidenti, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. "Pas këtij incidenti diaspora e shqiptarëve të Kosovës, u  
18 aktivizua, u bë më aktive në krijimin e një ushtrie të  
19 unifikuar me një strukturë komanduese. Mirëpo, kjo objektivë  
20 herë cenohej apo rrezikohej nga përleshjet e brendshme brenda  
21 komandantëve të zonave, veçanërisht midis Haradinajt, Shalës  
22 dhe Remit, dhe rezistencës së komandantëve të zonave që të  
23 marrin udhëzime apo urdhra nga udhëheqësia politike e UÇK-së."

24 A jeni në dijeni për këto përleshje, për këto entitete  
25 politike brenda UÇK-së?

1 PË. Kjo nuk ka qenë fushëveprimi im.

2 PY. A nuk dini asgjë për këtë? A nuk është një fakt se UÇK-ja  
3 në verën e 1998, sipas Shaun, ishte plot me përleshje të  
4 brendshme.

5 PË. Kjo është një vlerësim i një analisti. Unë nuk mund të  
6 komentoj në lidhje me vlerësimet e tij.

7 PY. Po në bazë të analizës që keni bërë ju në atë kohë, në  
8 lidhje me korrikun apo verën e atij viti, a nuk do të  
9 pajtoheshit me mua se UÇK-ja ka qenë përplot me konflikte të  
10 brendshme?

11 PË. Unë nuk kam informacion që kam marrë unë vetë në lidhje  
12 me këtë pyetje.

13 PY. A e njihni një ushtarak David Wilson?

14 PË. Po, e njoh.

15 PY. Mendoj që përkthyesit do të na hidhërohen se flasim shumë  
16 shpejt.

17 PË. [Nuk ka përkthim]

18 PY. A e njihni një ushtarak të lartë David Wilson të ushtrisë  
19 së Mbretërisë së Bashkuar?

20 PË. Nuk e njihja, mirëpo e njofta në Rahovec. Konkretisht kur  
21 më çoi me veturë nga Shqipëria në Kosovë në korrik.

22 PY. Tani, do t'ju lexoj një pjesë të raportit që ka bërë z.  
23 Wilson.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Është dokumenti SPOE00117127 deri në  
25 7132. Dhe fragmenti që do të lexoj është në faqen 7129.

1 PY. Dhe ai aty thotë:

2 "Mbas nevojës, KDOM-i i Britanisë së Madhe i është  
3 eksponuar UÇK-së si operacionet e UÇK-së. Fotografia e  
4 përgjithshme është kjo se kryesisht janë grupe të fragmentuara  
5 dhe këto grupe janë zakonisht të vogla. Grupi më i madh që  
6 kanë parë pjesëtarët e KDOM-it nuk ka pasë më shumë se 40  
7 anëtarë. Këto janë grupe udhëheqësish politikë kryesisht nga  
8 diaspora, dhe grupe të armatosura me armë jo shumë të mira dhe  
9 jo shumë faktikisht të armatosura, si grupe fshatarësh të  
10 cilët ishin rekrutuar aty nga vendi."

11 A pajtoheni me këtë vlerësim të z. Wilson?

12 PË. Roli im ka qenë që të kryeja një hetim për të drejtat e  
13 njeriut në lidhje me personat e zhdukur. Në këtë drejtim, unë  
14 shkoja në patrullime në zonat e UÇK-së dhe ndonjëherë ndodhte  
15 që hasnim në trupa të UÇK-së, forca të UÇK-së, mirëpo ata  
16 ishin përgjithësisht të uniformuar dhe të armatosur dhe ishin  
17 qartësisht anëtarë të UÇK-së. Kaq mund të them unë për sa i  
18 përket kontaktit tim të drejtpërdrejtë me njerëz që janë me  
19 grada. Unë nuk kam dijeni të drejtpërdrejtë që të komentoj në  
20 lidhje me vlerësimet që m'i paraqisni ju.

21 Ka një profesor, Pettifer, që ka shkruar në Oksford një  
22 raport në lidhje me UÇK-në dhe ai mund ndoshta t'ju japë  
23 mendimet e veta në lidhje me strukturën organizative të asaj  
24 ushtrie.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Është ora 13.00. Tani duhet të bëjmë

1 pushimin e drekës.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta bëjmë  
3 pushimin e drekës deri në 14.30. Sekretarja do t'ju nxjerrë  
4 jashtë sallës.

5 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju e keni të  
7 qartë se sa është e vështirë kjo pyetje e mendimeve të  
8 tjerëve. Keni nxjerrë katër mendime të personave të ndryshëm  
9 gjatë kësaj periudhe të shkurtër të pyetjeve që keni bërë.

10 Z. KEHOE: [Mikrofoni çaktivizuar]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thjesht po ju  
12 ilustruj se sa e vështirë mund të jetë kjo.

13 Z. KEHOE: [Mikrofoni çaktivizuar]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do të  
15 bëjmë pushimin e drekës, a keni diçka tjetër për të shtuar?

16 Z. KEHOE: [Mikrofoni çaktivizuar]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shihemi në  
18 orën 14.30.

19 -- Pauza e drekës fillon në orën 13.02

20 --- Seanca rifillon në orën 14.30

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

22 Sekretare, ju lutem, sillni dëshmitarin në sallë.

23 Z. BAARLINK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam një  
24 çështje për të ngritur përpara sesa të vijë dëshmitari.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni

1 çaktivizuar]

2 Z. BAARLINK: [Përkthim] Në listën e dokumenteve për  
3 Mbrojtjen e Thaçit ka shumë dokumente të cilat kanë të bëjnë  
4 me dëshmitarë që kanë dhënë dëshmi në këtë proces gjyqësor nën  
5 masa mbrojtëse. Kështu që thjesht duam që të sigurohemi që  
6 këto dokumente të mos i tregohen dëshmitarit në mënyrë të  
7 tillë që do të cenonin masat mbrojtëse të cilat janë urdhëruar  
8 prej jush, Gjykatës të nderuar.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, e kuptoj. E kuptoj atë çfarë  
10 thotë Prokurori e kështu që do të ndjekim udhëzimet që na janë  
11 dhënë sa i takon tregimit të këtyre dokumenteve për  
12 dëshmitarin, në mënyrë të tillë që të mos nxjerrim  
13 informacionin identifikues të personave që janë nën masa  
14 mbrojtëse.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
17 do të vazhdojmë me kundërpjetjen tuaj nga Mbrojtja e  
18 Thaçit. Jeni nën detyrimin të tregoni të vërtetën.  
19 Vazhdoni, z. Kehoe.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit.

21 PY. Mirëdita.

22 PË. Mirëdita.

23 PY. Të vazhdojmë aty ku e lamë që ka të bëjë me kohën kur u  
24 larguat dhe shkuat në Rahovec. Ju e dini që UÇK-ja ishte një  
25 ushtri vullnetare dhe njerëzit mund të largoheshin kurdo që të



1 donin.

2 PË. Kam reflektuar gjatë periudhës së drekës edhe dua të  
3 sqaroj nja dy-tre gjëra.

4 PY. Ju lutem, përgjigjuni pyetjes time një herë dhe pastaj  
5 jepni shpjegimet e tjera.

6 PË. Ka të bëjë me të njëjtën gjë. Me të njëjtën temë. Unë  
7 thashë që kam qenë në territoret e UÇK-së nja dy-tre herë.  
8 Është e drejtë të themi, të them që ka pasur raste që ato  
9 njësive të cilat diskutohet, domethënë, ishin *ad-hoc*,  
10 domethënë, ishin njësive të cilat përbëheshin nga persona që  
11 ishin vërtet fshatarë apo persona të cilët ishin të zonës aty;  
12 ishin guximtarë, merrnin armët edhe bënë pjesë të këtyre  
13 njësiveve ose të njësiveve të ndryshme të cilat ju i përmendët  
14 pak më herët.

15 PY. Në qoftë se do të shikojmë performancën e UÇK-së, a  
16 mbërritët në një përfundim që UÇK-ja nuk kishte vazhdimësi,  
17 nuk kishte kohezion, nuk kishte aftësi, për shembull, që t'i  
18 përgjigjej manovrave ose ofensivave të ndryshme të cilat  
19 shfaqeshin nga pala tjetër?

20 PË. M'u krijuar përshtypja që në fakt komandantët e lartë ose  
21 personat të cilët ishin më me aftësi ndërmjet UÇK-së që janë  
22 vrarë gjatë operacioneve të verës. Megjithatë, domethënë, siç  
23 e thashë nuk mund të them që ata kishin të njëjtën aftësi siç  
24 ka pasur ushtria serbe.

25 PY. Nuk dua t'ju ndërpres, domethënë, në qoftë se doni që të

1 vazhdoni më tej, ju lutem, më thoni. Nuk është synimi im që  
2 t'ju ndërpres, domethënë, ju kërkoj ndjesë paraprakisht në  
3 qoftë se e bëj këtë gjë. E bëj ndonjëherë, më duhet ta them,  
4 kështu që ju lutem, në qoftë se nuk e keni përfunduar  
5 përgjigjen vazhdoni më tej sepse duam që të dëgjojmë deri në  
6 fund për ato çfarë keni për të thënë. Pra, e kam si tendencë  
7 që t'i ndërpres njerëzit, kështu që, më thoni nëse ndodh kjo.

8 Atëherë, juve keni njohur, duke parë luftën në Rahovec në  
9 korrik të vitit 1998 dhe në fakt e keni thënë këtë në  
10 intervistën me TPNJ-në në nëntor të vitit 2000, në Provën  
11 Materiale 232

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe kjo jepet në numrin 01068157.

13 Atëherë po flasim për Rahovecin.

14 "Nuk ka prova që UÇK-ja ka treguar ndonjë rezistencë në  
15 këtë kundërsulm. Njëri, një person më tha që thjesht iku, ikën  
16 dhe i lanë të tjerët që të përballëshin me pasojat.

17 Atëherë kur flitet për rimarrjen e Rahovecit nga serbët,  
18 UÇK-ja nuk tregoi asnjë rezistencë dhe i la njerëzit që të  
19 përballëshin me pasojat.

20 PË. Po.

21 PY. A jeni dakord me vlerësimin e brigadier Meyers-it.

22 PË. Ju kërkoj ndjesë. Meyers, kush është Meyers?

23 PY. Brigadier David Meyers?

24 Në fakt bëhet fjalë për David Meyers, një tjetër individ  
25 i cili ishte i pranishëm aty. Gjenerali, pra, David Meyers.

1 "Pra, gjatë gjithë ofensivës së verës, performanca e UÇK-  
2 së ishte me shumë defekte. Mungonte kohezion ndërmjet grupeve  
3 të ndryshme. Kishte komandë joekzistente, kontroll të keq,  
4 kishte influencë të kufizuar të ushtarëve ish-profesionistë  
5 dhe UÇK-ja nuk mund të thuhet ose mund të thuhet që ka, që  
6 është mundur në të gjithë fushatën dhe kjo për shkak të  
7 ndërhyrjes së komunitetit ndërkombëtar. Megjithatë, është  
8 absolutisht e qartë që në aspektin politik dhe në aspektin  
9 ushtarak ata kanë qenë në një situatë shumë të keqe, në atë  
10 verë, në fund të verës.

11 Atëherë, pyetje ime është kjo: Domethënë me aq sa keni  
12 parë juve, se me aq sa keni sa mund të vlerësoni ju sa i takon  
13 luftimit të UÇK-së dhe kundërsulmeve të Serbisë në korrik të  
14 vitit 1998. Çfarë mund të thoni?

15 PË. Unë nuk kam vlerësuar fare aftësitë taktike. Megjithatë,  
16 nuk është se nuk jam dakord me komentin që sapo lexuar.

17 PY. Kur shohim dhe në fakt, ju dhatë ca opinione që kanë të  
18 bëjnë me komandën dhe kontrollin të cilat do t'i cekim  
19 gjithashtu. Edhe në pyetjet, megjithatë, këtë e keni thënë  
20 edhe në deklaratën tuaja për ZPS-në. Për procesverbal, këtë e  
21 keni thënë në paragrafin 12. Dua t'jua jap datën ashtu siç  
22 është, pra, datën e saktë lidhur me Provën Materiale 230. Ju  
23 thoni:

24 "Sa i takon 'Komandës së Lartë' të UÇK-së, unë e kisha  
25 idenë që kishte një komandë të një niveli më të lartë, por nuk

1 e dija çfarë ishte kjo”.

2 Më pas, në këtë deklaratë, në paragrafin 12, ju thoni:

3 “Ne i dinim se si quheshin komandantët e zonave, por të  
4 paktën unë nuk e kisha idenë se kush ishte i përfshirë në  
5 komandën më të lartë”.

6 A është e saktë kjo? Pra, që ju nuk e kishit idenë se  
7 kush ishte i përfshirë në komandën më të lartë të UÇK-së?  
8 PË. Po, kështu ka qenë në ditët e para të kohës sime atje.  
9 Por drejt fundit të qëndrimit tim kam krijuar përshtypjen e  
10 mia sa i takon kësaj çështjeje, të cilën e kam thënë edhe në  
11 deklaratat e mëpasshme.

12 Ju lutem, po thoja, nuk kam përfunduar akoma. Pra, neve,  
13 dhe kur themi neve, e kam fjalën për veten time dhe për  
14 kolegët e tjerë që ne, pra, informacioni që mua më është  
15 dhënë, siç e sugjeruat edhe ju nga pyetje juaj, ishte shumë i  
16 kufizuar dhe nuk është se morën asnjë informacion nga UÇK-ja  
17 për sa i takon personave të zhdukur që ishte shqetësimi  
18 kryesor i yni.

19 PY. Siç i keni thënë ZPS-së, pra, kishte një komandë më të  
20 lartë të UÇK-së, por ju nuk e dini se kush ishte kjo komandë.  
21 Gjithashtu i keni thënë ZPS-së në të njëjtin paragraf që:  
22 “Mua nuk më kujtohet që Thaçi të jetë i përmendur në këtë  
23 listë deri në Rambuje. Megjithatë, ne kemi qenë të  
24 keqinformuar për të gjithë strukturën e përgjithshme të UÇK-  
25 së”.

1 A është e saktë kjo? Domethënë që nuk keni dëgjuar asgjë  
2 rreth z. Thaçit deri në Rambuje?

3 PË. Po.

4 PY. Pra, është e saktë gjithashtu që nuk keni dëgjuar asgjë  
5 dhe për strukturën?

6 PË. Siç e thashë, po.

7 PY. Po për komandantët e zonave, kush ishin emrat e  
8 komandantëve të zonave kur keni shkuar në Pashtrik në vitin  
9 1998, në nëntor të '98-s?

10 PË. Në zonën e Pashtrikut --

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, mos  
12 flisni mbi njëri-tjetrin.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju kërktoj ndjesë. Është faji im. E  
14 bëj gjatë gjithë kohës, por do të mundohem ta korrigjoj.

15 PY. Edhe një herë, ku bën pjesë Rahoveci, në çfarë zone është  
16 Rahoveci?

17 PË. Nuk e di, por nga pyetja juaj i takon që është në zonën e  
18 Pashtrikut. Unë nuk kam qenë analist në atë kohë.

19 PY. Pavarësisht kësaj, a e dini se kush ishte komandant i  
20 zonës?

21 PË. Me sa më kujtohet ka qenë, kanë qenë tre komandantë të  
22 zonës, ka qenë Haradinaj, më kujtohet edhe një Remi dhe më pas  
23 e di që edhe Drini e mori detyrën diku në janar. Përpara kësaj  
24 nuk e kam ditur se kush janë këta.

25 PY. Po në zonën e Llapit ka qenë Remi? Ndërkohë që në zonën e

1 Dukagjinit ka qenë Haradinaj, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Po nuk ju kujtohet, ju thatë që përpara Drinit nuk ju  
4 kujtohet se kush ka qenë komandant i zonës në zonën e  
5 Pashtrikut, kështu?

6 PË. Jo, nuk më kujtohet. Por në qoftë se ma thoni emrin mbase  
7 më kujtohet.

8 PY. Në qoftë se do shohim atë se çfarë ka ndodhur në verën e  
9 '98-s në Rahovec. Keni pasur kontakte me një individ që quhej  
10 "Sosi", apo jo?

11 PË. Disa herë. Kam pasur kontakte disa herë në mënyrë të  
12 drejtpërdrejtë. Mendoj që shefi im Ian McLeod është takuar me  
13 të disa herë. Disa herë të tjera. Po mundohesha të kujtoja  
14 mbase mund të më kujtohen dy takime të drejtpërdrejta që e kam  
15 takuar atë ballë për ballë, personalisht. Megjithatë, me sa më  
16 kujtohet kolegët e mia janë takuar me të në mënyrë më të  
17 rregullt sesa mua.

18 PY. Po keni folur me të apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Dëshiroj të lexoj diçka që është Sabahudin Cena që është  
21 Sosi.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Për procesverbal është dokumenti në  
23 rreshtin 17 deri në faqen 18, rreshti 4. Domethënë, Pjesa 4,  
24 faqja 17, vazhdon më tej në faqen 18 në rreshtin 4.

25 PY. Profesor Cena, avokati juaj ngriti një çështje të cilën

1 për të cilën dua t'ju pyes sot. Ai tha që në pranverë ose verë  
2 të '98-s UÇK-ja kishte një strukturë organizative dhe zinxhir  
3 komande që u zhvilluar me kohën. A mund të na e shpjegoni këtë  
4 gjë?

5 "PË. Nuk ka pasur zinxhir komande. Ai është ndërtuar mbi  
6 bazë vullnetare".

7 A e keni konstatuar edhe ju këtë gjë?

8 PË. Nuk e komentoj dot këtë gjë.

9 PY. Nuk keni arsye për të vënë në pikëpyetje atë çfarë ka  
10 thënë një individ që ka qenë pjesë e UÇK-së atëherë.

11 PË. Jo. Është diçka që nuk ka lidhje drejtpërsëdrejti me  
12 punën time, por në atë kohë nuk ishte një gjë që më  
13 shqetësonte mua. Nuk kishte një gjë për të cilën unë kisha  
14 lidhje.

15 PY. A jeni në dijeni që në zonën e Rahovecit, ata filluan që  
16 të organizoheshin nga prilli i vitit 1998. A e dini këtë gjë?

17 PË. E di tani.

18 PY. Vetëm tani? Në rregull. A jeni në dijeni që në atë kohë,  
19 domethënë, ishin thjesht fillesat, fillimet, por me kalimin e  
20 kohës siç tregohet edhe në raportin e OSBE-së,

21 "Ashtu siç është parë, ashtu është treguar" që ata janë me  
22 armë, domethënë, kanë pasur armë, pak armë dhe pak furnizime?

23 PË. Mendoj që kemi qenë të qartë në këtë.

24 PY. Dhe nuk kam pasur shumë furnizime apo jo?

25 PË. Nuk kam arsye për ta vënë në dyshim këtë gjë.

1 PY. Dhe shumë prej personave të rekrutuar nuk ishin, që ishin  
2 vullnetarë sigurisht, nuk kishin as armë?

3 PË. Absolutisht, po. Nuk është pazakontë për ato rrethana që  
4 situata të ketë qenë e tillë.

5 PY. Gjatë asaj periudhe a ka pasur spiunë, bashkëpunëtorë,  
6 persona të infiltruar në mesin e tyre?

7 PË. Padyshim.

8 PY. Në fakt a jeni në dijeni që UÇK-në në raste të ndryshme  
9 në pranverë dhe në verë të '98 janë zënë pritë ose janë zënë  
10 në kurth për shkak të faktit ose mbështetur në faktin që  
11 informacioni kishte rrjedhur nga ana tjetër ose i është dhënë  
12 palës tjetër ose anës tjetër?

13 PË. Padyshim, nuk, po ky është roli i zbulimit ushtarak.

14 PY. Por kur flitet për Rahovecin ju besoj që e dini që UÇK-ja  
15 nuk mund ta përballonte një ofensivë të forcave serbe në atë  
16 kohë apo jo?

17 PË. Është e drejtë besoj që të thuhet që shumë njerëz të  
18 Rahovecit mund të thonë që nuk kishin të gatshëm ta bënë një  
19 gjë të tillë. Megjithatë, nuk do çuditesha që ata të mund të  
20 mos kishin aftësi për të përballuar një luftë të tillë.

21 PY. Sigurisht që Ushtria Jugosllave kishte shumë herë më  
22 tepër armë edhe forca sesa UÇK-ja, pajtoheni me mua për këtë?

23 PË. Po.

24 PY. A jeni të informuar se gjatë kësaj periudhe ushtarët e  
25 UÇK-së e dezertonin, i dezertonin postet e tyre dhe nuk bënë



1 atë çfarë mendohej që të bënin?

2 PË. Jo, megjithatë, edhe një gjë e tillë nuk do ishte  
3 surprizuese, nuk do më befasonte.

4 PY. Në rregull. Keni folur për personin që quhet Toni. Emri i  
5 plotë i personit është Xhelal Hajda. Dhe thatë që keni goxha  
6 konsideratë për të.

7 PË. Unë nuk është se e kam pas këtë opinion personalisht, por  
8 personat me të cilët flisja unë më kanë transmetuar një  
9 opinion shumë të lartë ose një konsideratë shumë të lartë për  
10 këtë person. Dhe këtu e kam fjalën për disa njerëz si persona  
11 serbë në qytet.

12 PY. Në rregull. Më lejoni të tregoj një provë materiale të  
13 ZPS-së.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Është prova P67.

